



Konsultimet rajonale
me viktimat, me të rinj, me gazetarë dhe me organizatat për të drejtat e njeriut për
Komisionin Rajonal për Zbardhjen e të Vërtetës mbi Krimet e Luftës në ish Jugosllavi

26.06.2008

Hotel *Palace*, Mitrovicë, Kosovë

09.00 – 10:00	Fjala e hapjes: Nisma Rajonale për një Komision Rajonal për Zbulimin e Fakteve mbi Krimet e Luftës në ish Jugosllavi: mbajtja e konsultimeve Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare
10:00 – 10:15	Pauzë
10:15 – 12:15	Grupet e punës - Prezantimi i qëllimeve dhe i detyrave të grupeve të punës - Përcaktimi i nënqëllimeve të grupeve të punës - Hartimi i strategjisë së veprimit të grupeve të punës - Hartimi i planit të veprimit: - formulimi i rendit të ditës së Forumit - pjesëmarrësit e Forumit - organizimi i dëgjimit publik të viktimave Moderatorët: Kryesuesit e grupeve të punës
12:15 – 12:30	Pauzë
12:30 – 13:00	Raportet e grupeve të punës: moderatorët

13:00 - 14.00	Dreka
14.00 – 16:00	Komisioni Rajonal për Zbardhjen e të Vërtetës mbi Krimet e Luftës në ish Jugosllavi: - Prezantimi i nismës rajonale për ngritjen e Komisionit Rajonal për Zbardhjen e të Vërtetës mbi Krimet e Luftës në ish Jugosllavi. - Rëndësia e zbulimit të fakteve mbi krimet e luftës të kryera në të kaluarën. - Modelet dhe karakteristikat e një Komisioni të mundshëm Rajonal Moderator: Vesna Teršelič, Documenta
16.00 – 16.30	Pauzë
16:30 – 18:00	Komisioni Rajonal për Zbardhjen e të Vërtetës mbi Krimet e Luftës në ish Jugosllavi, pjesa II
18:00 – 18:30	Fjala përmbyllse: pjesëmarrësit dhe organizatorët

Valdete Idrizi: Ja kam mësuar emrat si zonjë e shtëpisë, sepse ashtu po ndjehem ne Mitrovicë, njëkohësisht edhe si anëtare e Grupit Koordinues, në gjithë këtë proces, në këtë iniciativë, dëshiroj t'ju përshëndes të gjithëve, njëkohësisht edhe t'ju falënderoj që ju keni përgjigjur ftesës sonë, në këtë vazhde të proceseve të konsultimeve, rreth nismës për themelimin e këtij Komisioni. D.m.th., për më gjatë, do të flasë Vesna Teselic më vonë, që t'ju informojë gjithë juve se çfarë është bërë deri tash, edhe pse disa prej jush tanimë jeni të informuar, keni marrë pjesë në disa takime konsultative, e disa prej jush keni shprehur interesimin, e nuk jeni aq thellësisht të informuar. Kështu, besoj që Vesna tani do të japë një sqarim më të gjerë dhe më të thellë.

Vesna Tershelliq: Mirëdita të gjithëve, më vie shumë mirë që sot këtu jemi kaq shumë. Gjithnjë është më mirë të shohim dhomën e mbushur se sa të brengosemi se a ka njerëz të interesuar për iniciativën për themelimin e Komisionit Rajonal, prandaj kjo më ngjall shpresën se po e shoh se ka. Këto janë konsultimet e dhjeta me radhë; kemi mbajtur konsultime dhe Forume në Kroaci, në Bosnjë dhe Hercegovinë, në Serbi, në Mal të Zi dhe tash jemi në Kosovë dhe jemi duke përgatitur një Forum të madh në Prishtinë, i cili do të mbahet më vonë në tetor të këtij viti. Jemi konsultuar me organizatat e viktimave, me veteranët, me organizatat për të drejtat e njeriut, me rininë, me artistët. Janë mbajtur Forumet në Sarajevë, Zagreb dhe Beograd dhe Forumi në Prishtinë do të jetë i katërti me radhë; të gjithë me temën e qasjes Rajonale për përcaktimin e fakteve dhe përcaktimin e të vërtetës dhe që nga fillimi jemi pajtuar se qasja Rajonale është shumë e rëndësishme dhe se nuk mund të përcaktojmë faktet mbi krime pa bashkëpunim; sepse nga perspektivat e ndryshme duhet të shohim se çka ka ndodhur e për këtë na nevojitet niveli Rajonal. Mos ta zgjas më shumë, më vonë Natasha Kandiq do të na flas më tepër për iniciativën për themelimin e Komisionit Rajonal, e në fillim do të doja që të gjithë të prezantohemi shkurtimisht, për të ditur se kush është prezent. Krejt shkurt, emrin, mbiemrin dhe nga cila organizatë jeni.

Hysni Berisha: Unë jam Hysni Berisha, kryetar i shoqatës për identifikimin (?) e krimeve ... e Shpresimit” nga Suhareka.

Lush Krasniqi :Unë quhem Lush Krasniqi, vij nga komuna e Gjakovës, jam familjar me të zhdukur dhe viktimë të luftës, në masakrën e 27 prillit 1999 në Meje.

Emina Buzhinkiq: Emina Buzhinkiq, Qendra për studimet paqësore dhe Rrjeti i të rinjve të Kroacisë.

Sabit Kadriu : Sabit Kadriu, Komisioni për hulumtimin e krimeve të luftës, Vushtrri.

Krenare Maloku : Krenare Maloku BIRN

Ramadan Iljazi: Ramadan Iljazi nga Iniciativa për Progres (INPO)

Zana Haxhiavdyli: Zana Haxhiavdyli, Drejtoreshë Ekzekutive e organizatës.... familja ???

Burim Nura; Burim Nura, Fondacioni për Iniciativa Demokratike, Gjakovë

Naser Lajqi : Naser Lajqi, nga OJQ “Syri i Vizionit” Pejë.

Lulëzim Gërqina : Lulëzim Gërqina, Fondacioni për Iniciativa Demokratike, Gjakovë

Xhemajli Thaqi : Xhemajli Thaqi, Shoqata e Ish të Burgosurve Politikë “143+2”, Gjakovë

Afrim Caka: Afrim Caka, Shoqata e Ish të Burgosurve Politikë “143+2”, Gjakovë, një nga të mbijetuarit e masakrës së Burgut të Dubravës

Urim Zhubi: Urim Zhubi, Kryetar i Shoqatës së Ish të Burgosurve Politikë “143+2”, Gjakovë,

Nehari Sharri: Nehari Sharri, nga Shoqata Gjermane “Forum ZFD”

Shukrije Gashi: Shukrije Gashi, Drejtoreshë e Qendrës për Administrimin e Konfliktëve, Partneret Kosova

Belxhyzare Muharremi: Belxhyzare Muharremi, vij nga Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës,
Florent Hajrizi: Florent Hajrizi, Udhëheqës i Shërbimit për Ndërmjetësim, Partners Kosova
Sakibe Jashari: Sakibe Jashari nga Ambasada Zvicerane në Kosovë
Kushtrim Koliqi: Kushtrim Koliqi, Integra Prishtinë
Agon Vrenezi: Agon Vrenezi, OHCHR, Zyra në Kosovë,
Paul Miller: Paul Miller, OHCHR, Zyra në Kosovë,
Avni Melenica: Avni Melenica, Vushtrri, familjar i pesë anëtarëve të zhdukur, 22 maj 1999
Lazar Ampovski: Lazar Ampovski, Mitrovicë: Qendra për zhvillimin e shoqërisë civile, Kosovë.
Aleksandar Stojanoviq: Aleksandar Stojanoviq, Qendra për zhvillimin e shoqërisë civile, Mitrovicë, Kosovë,
Sara Maliqi: Sara Maliqi, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Prishtinë,
Ramadan Asllani: Ramadan Asllani, Rrezja e Shpresës, Ferizaj,
Ilir Dugolli: Ilir Dugolli, KIPRED, Kosovë,
Saranda Dakaj: Saranda Dakaj, KIPRED, Kosovë,
Mentor Nimani: Mentor Nimani, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Prishtinë,
Afërdita Syla: Afërdita Syla, M – Magazine, Mitrovicë/Mitrovica, Kosovë,
Besart Lumi: Besart Lumi, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Prishtinë, Kosovë,
Fatmire Haliti: Fatmire Haliti, Qendra për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës,
Arjana Zherka: Arjana Zherka USAID, Zyra në Kosovë,
Behxhet Shala: Behxhet Shala, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Prishtinë, Kosovë,
Haxhi Krasniqi: Haxhi Krasniqi nga Skenderaj, Fondacioni Kujtimi,
Bekim Blakaj: Bekim Blakaj, Fondi për të Drejtën Humanitare,
Andrej Nosov: Andrej Nosov, Iniciativa e të rinjve për të drejtat njerëzore, Serbi,
Amir Kulagliq: Amir Kulagliq, Shoqata qytetare Gratë e Srebrenicës, Bosnë dhe Hercegovinë/BIH,
Valdete Idrizi: Valdete Idrizi, Community Building, Mitrovicë, Kosovë,
Natasha Kandiç: Natasha Kandiç Fondi për të drejtën humanitare, Serbi,
Anka Kurteshi Hajdari: Anka Kurteshi Hajdari, Fondi për të drejtën humanitare, Kosovë,
Katarina Kruhonja: Katarina Kruhonja, Qendra për paqe, jo dhunë dhe të drejtat e njeriut nga Osijeku, Kroaci,
Shpresim Arifi: Shpresim Arifi, Fondi për të Drejtën Humanitare, Kosovë,
Sabina Hasanaj: Sabina Hasanaj, Fondi për të Drejtën Humanitare, Kosovë,
Besnik Krasniqi: Besnik Krasniqi, Fondi për të Drejtën Humanitare, Kosovë,
Nixhara Ahmetasheviq: Nixhara Ahmetashević BIRN, Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë,
Zdravka Karlica: Zdravka Karlica, Organizata komunale e të burgosurve dhe luftëtarëve të vrarë dhe personave të zhdukur, Prijedor, Bosnë dhe Hercegovinë,
Edin Ramuliq: Edin Ramulić, Shoqata ” Izvor ”, Prijedor, Bosnë dhe Hercegovinë,
Budimir Ivanišević: Budimir Ivanišević, Fondi për të drejtën humanitare, Serbi,
Lejla Mamut: Lejla Mamut, Qendra për hulumtime dhe dokumentime, Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë,
Yll Buleshkaj: Yll Buleshkaj, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Kosovë,
Sandra Orloviq: Sandra Orloviq, Fondi për të drejtën humanitare, Serbi,
Dushan Xhordević: Dushan Xhordević, Fondi për të drejtën humanitare, Serbi,
Jelena Simiq: Jelena Simiq, Fondi për të drejtën humanitare, Serbi,

Tanja Petroviq: Tanja Petroviq, Documenta, Zagreb, Kroaci,
Igor Roginek: Igor Roginek, Documenta, Zagreb, Kroaci,
Dragan Popoviq: Dragan Popoviq, Iniciativa e të rinjëve për të drejtat e njeriut, Serbi,
Milan Antonijeviq: Milan Antonijeviq, komiteti i juristëve për të drejtat e njeriut, YUKOM, Serbi,
Milot Berisha: Milot Berisha, Iniciativa e të rinjeve për të drejtat njerëzore, Kosovë,
Valid Zhubi: Valid Zhubi, Iniciativa e të rinjve për të drejtat njerëzore, Kosovë,
Izedim Krasniqi: Izedim Krasniqi, Koha Ditore, Kosovë,
Mirko Kovaqiq: Mirko Kovaqiq, Shoqata e nënave nga Vukovari dhe kuvendi i mesëm për kërkimin e të humburve, Zagreb, Kroaci,
Maja Stojanoviq: Maja Stojanoviq, Iniciativa e të rinjve për të drejtat e njeriut, Serbi,
Eugen Jakovqiq: Eugen Jakovqiq, Cenzura plus –Shoqata për lëvizjen e të drejtave njerëzore dhe mediale, Split, Kroaci,
Abdullah Ferizi: Abdullah Ferizi, Ndërtimi i komuniteteve, Mitrovicë,
Arlind Gllgjani: Arlind Gllgjani, OJQ “Syri i Vizionit,
Ferdane Osmani: Ferdane Osmani, Qendra Juridike e Kosovës,
Bardhyl Dinaj: Bardhyl Dinaj, Programi për të Drejtat Civile Mitrovicë,
Zija Avdullahi: Zija Avdullahi, RTK, Kosovë
Zorica Trifunoviq: Zorica Trifunoviq, Quaker Peace & Social Witness, Beograd, Serbi
Staša Zajoviq: Gratë në të zeza, Beograd, Serbi,
Nela Pamukoviq: Qendra për gratë viktime të luftës ROSA, Zagreb, Kroaci.
Vesna Tersheliq: Më duket se të gjithë jemi prezantuar. Unë jam Vesna Tersheliq nga Documenta nga Zagrebi dhe tash do t’ia jap fjalën Natasha Kandiqit që të na flas për iniciativën për themelimin e Komisionit Rajonal për përcaktimin e fakteve mbi krimet e luftës.
Natasha Kandiq: Para se të filloj të flas për iniciativën, kam nevojë të them dy – tri fjalë për një ngjarje nga qershori i vitit 1999. Pse? Për arsye se sot, pas nëntë viteve e kam parë Mentor Nimanin, i cili atëherë, në atë kohë, ka punuar për Fondin për të drejtën humanitare, e këtu është edhe Ariana Zherka e cila poashtu ka punuar atëherë. Atëherë, kjo ka qenë ndoshta më 25 apo 26 qershor, zyra jonë ka qenë e mbyllur, kompjuterët i patën marrë kurse në planifikim se si ta largojmë personelin nga Prishtina. Kemi tentuar që të shkojmë kah kufiri maqedonas dhe kur atje kemi parë formacionet e maskuara, u tmerruam dhe jemi kthyer prapë në Prishtinë. Pastaj menduam të tentojmë prapë dhe me automobil të vijmë gjer në Beograd, e prej Beogradi të shkohet në Mal të Zi. Në atë kohë na dukej se prej Malit të Zi mund të shkohet kudo. E atëherë u nisëm unë, Sava, i cili ishte vozitësi ynë, e i cili u bë legjendë me atë se me sa sukses i kalonim kontrollat e ndryshme, ka qenë Mentori, ka qenë Nora Ahmetaj dhe vëllai i saj Kushtrimi, i cili nuk ka ditur asnjë fjalë serbisht. I kemi kaluar disa pika kontrolluese të policisë duke u thënë se kemi qenë në vizita familjare dhe po kthehemi në Beograd, dhe se prapë do të vijmë, dhe në këtë mënyrë ai ka kaluar mire në të gjitha pikat kontrolluese. Nuk na kanë kërkuar dokumentet e identifikimit, ne të gjithë edhe ashtu vdisnim nga frika, por kalonim. Kur arritëm diku afër Gjilanit, na ndaloi një njësit ushtarak kontrollues dhe kërkuan nga ne dokumentet tona personale, dhe ne ishim të detyruar t’ua tregojmë, ashtu që ata e kuptuan se në veturë gjenden serbët dhe shqiptarët. Dhe kjo ka qenë shokuese për ta dhe duke i falënderuar faktit se aty ishte një oficer, domethënë nuk ishin oficer rezervë, nuk ishte ndonjë grup paramilitar po një oficer i rregullt i cili i shikoi letër njoftimet, nuk e pati asnjë koment, na pyeti se kush jemi. Ne iu përgjigjëm se jemi organizatë humanitare dhe se ofrojmë ndihma humanitare dhe kështu na lëshuan. E ne vazhduam tërësisht të hutuar sepse do të mund të kishim hasur në pika kontrolluese ku do të na

urdhëronin të ndaheshim, dhe ne vërtetë frikoheshim edhe vetëm të mendonim se çfarë do të mund të ndodhte. Dhe pas disa ditësh e bëmë të mundur që Mentori, Nora dhe Kushtrimi të largohen nga Beogradi, por sidoqoftë kjo ka qenë një situatë të cilën e kujtojmë gjithnjë dhe konstatojmë se po të mos ishte ai vozitës i cili dinte ashtu të bisedonte, komunikonte dhe tërhiqte vëmendjen e që askush të mos na kërkonte dokumentet, nuk e di se si to të përfundonte e gjithë ajo. Ja, ky është një përkujtim nga ai qershor i vitit 1999. Kanë kaluar plotë nëntë vite që nga atëherë. Nëntë vite dhe ne sot, shumica e të cilëve në ndërkohë kemi kaluar burgje të ndryshme, po e shoh këtu Burim Zhubin, po shoh se këtu qenkan shumë nga Gjakova të cilët në atë kohë kanë qenë në burgjet e Serbisë, po ka kaluar ajo periudhë dhe në atë kohë të shkuar na janë lajmëruar, e edhe ne vetë kemi ardhur gjer te disa njohuri, se ajo që ka ndodhur nuk bën, nuk mund të mbetet në nivelin e kujtesës individuale, ta lëmë frikën dhe mundësinë se krimi mund të përsëritet, brenda kornizës së tri organizatave tona nga shtetet e ish- Jugosllavisë, Fondi për të drejtën humanitare, Documenta nga Kroacia dhe Qendra për hulumtim dhe dokumentim nga Sarajeva, kemi filluar të mendojmë se si ti tejkalojmë kufizimet dhe pengesat të cilat po dalin nga gjykimet penale për krimet e luftës. Kemi kalkuluar se nëse do të kishim gjykime të tilla intensive në të gjitha shtetet e ish- Jugosllavisë, gjer në vitin 2020 nuk do të jenë më shumë se 1200 persona të cilët do të gjykohen dhe se shumica e atyre që kanë bërë krime, filluar nga 1 janari i vitit 1991 do të mbeten jashtë drejtësisë. Jemi konsultuar mbi përvojat e vendeve post konfliktuale dhe kemi parë se si ata po tentojnë ti zgjedhin problemin e kufizimeve objektive të gjykimeve për krime të luftës. Kjo është përvojë e themelimit të Komisionit për përcaktimin e të vërtetës, respektivisht përcaktimin e fakteve mbi kryerjen e krimeve të luftës. Kemi mësuar në shembujt dhe përvojat e atyre shoqërive dhe kemi parë që në shumicën e shteteve, këto komisione më së shumti që kanë arritur ka qenë kthimi i dinjitetit të viktimave, që zëri i viktimave të dëgjohet, të zgjojnë bashkëndjesin, solidaritetin shoqërorë në mes të qytetarëve, kanë bërë trysni në qeveritë e tyre dhe kanë arritur që ato të sjellin programet për reparacione për dëmshpërblimin e viktimave, kanë arritur të angazhojnë shoqatat e viktimave në aktivitete të cilat i përkasin punës dhe themelimit të këtyre komisioneve. Dhe atëherë, erdhëm gjer te një mendim se këto lloj shoqërish, siç janë shoqëritë nga territori i ish- Jugosllavisë, kërkojnë një lloj qasjeje të posaçme. Ne mund të shfrytëzojmë përvojat e mira të shoqërive dhe shteteve të tjera, po, edhe është se ne jemi një shembull specifik për shkak se lufta, kryerësit i kanë kaluar kufijtë, asgjë nuk ka ndodhur vetëm brenda një shteti, vetëm brenda një hapësire, po, sipas rregullës, krimet janë përgatitur në ndonjë vend tjetër, në ndonjë shtet tjetër dhe e gjithë kjo ka kaluar përtej kufijve në vend dhe shtet tjetër. Kjo na ka sjellë gjer te përfundimi se vetëm qasja Rajonale, vetëm ndonjë komision Rajonal mund të përcaktoj faktet mbi krimet e luftës, të cilat atëherë do të jenë të parashtruara, të paraqitura në tërë rajonin. Vetëm Komisioni Rajonal mund të organizoj një platformë publike për zërin e viktimave të cilat do të ndihen, dëgjohen dhe pranohen në të gjitha shtetet e ish- Jugosllavisë. Vetë Komisioni Rajonal mund të siguroj të krijohet ajo ndjenjë e domosdoshme dhembshurisë dhe solidaritetit me të tjerët. Atëherë kemi ardhur gjer te përfundimi se ajo iniciativë, në të vërtetë duhet të rrjedh nga shoqëria civile, se këtë iniciativë duhet ta bëjmë më të fortë, që duhet ti japim legjitimitet, që duhet ta përfitojmë përkrahjen ndërkombëtare që të mund ti drejtohem qeverive nacionale dhe të sigurohem se jemi aq të fortë që iniciativa jonë të jetë e pranuar dhe, që pas saj të pasojnë diskutimet parlamentare dhe marrja e vendimeve për themelimin e Komisionit Rajonal e cila do të përbëhet nga anëtarët nga rajoni ose do të ishte e përkrahur edhe nga anëtarët, të cilët eventualisht do të ishin të deleguar, nga Kombet e Bashkuara dhe Bashkësia Evropiane. Më tutje, duke u marrë përherë me idenë për këtë trup Rajonal, erdhëm gjer te përfundimi që trupi Rajonal mund të funksionoj nëse ekziston një

platformë e fortë nacionale, dhe këtë e kemi paramenduar përmes veprimtarisë së zyrave nacionale, ashtu që çdo shoqëri, çdo shtet, çdo popull nga territori i ish- Jugosllavisë, përmes këtyre zyrave nacionale të vij gjer te të dhënat e sakta, precize dhe autentike mbi atë se çfarë ka ndodhur brenda kornizës së asaj shoqërie, e të gjitha këto të dhëna, atëherë do t'i kishin ndihmuar atij Komisioni qendror Rajonal që të formoj dhe ndërtoj pasqyrën e krimeve të kryera, viktimave në proporcion me peshën e krimeve të kryera të luftës, në masë të madhe edhe pasqyrën e kryerësve, e cila atëherë do të ndihmonte prokurorinë nacionale për inicimin e procesit për krimet e luftës, por gjithashtu kjo do të ishte edhe materiali më i besueshëm për krijimin e përkujtimit kolektiv shoqëror ose kujtimit historik. Ne, në muajin maj të vitit 2006 e kemi organizuar Forumin e parë në këtë temë, të mbajtur në Sarajevë. Më se 300 pjesëmarrës kanë diskutuar mbi atë qasje Rajonale. Në atë kohë, në Sarajevë veç ekzistonte ideja për themelimin e një Komisioni nacional boshnjak. Në atë Forumin tonë janë dëgjuar këto mendimet tona, e ne kemi ftuar ekspertët të cilët janë marrë me ndërtimin e komisioneve në shoqëritë e ndryshme. Konkludimi gjer te i cili kemi ardhur në atë Forum është se në qoftëse ky komision nacional nuk shpie gjer te formimi i një Komisioni Rajonal, atëherë nuk do të ketë gjasa për të sjellë drejtësinë për ato viktimat, nuk do të sjellë një fotografi të plotë mbi krimet e kryera e as garancë që krimet nuk do të përsëriten. Pastaj, në muajin dhjetor të vitit 2006 kemi filluar të mbajmë konsultime të vogla, si këto që po i mbajmë në ditët e sotme. Këtë e kemi filluar me artistët dhe shkrimtarët nga rajoni; ku kanë marrë pjesë edhe regjisorët dhe shkrimtarët nga Kosova. Përfundimi i nxjerrë nga ato konsultime ka qenë se shkrimtarët, artistët, regjisorët, profesorët e fakultetit të artit dramatik, të bëjnë gjithë çka është e mundur që të mos vije gjer te falsifikimi i fakteve dhe manipulimeve me numrin e viktimave. Në muajin shkurt të vitit 2007, e kemi organizuar Forumin e dytë në Zagreb, i cili ka qenë tubimi më i madh i mbajtur ndonjëherë në Kroaci. Pas kësaj ne filluam me këto konsultime, i kemi organizuar me gazetarët, me rininë në nivelin nacional dhe Rajonal. Pastaj me shoqatat e viktimave, gjegjësisht me përfaqësuesit e shoqatave të viktimave dhe me viktimat në Podgoricë, si dhe me organizatat për të drejtat e njeriut, dhe konkludimi i përgjithshëm ka qenë se qasja Rajonale, trupi Rajonal, Komisioni Rajonal për përcaktimin e fakteve duhet të jetë prioritet i aktiviteteve të shoqërisë civile në lobimin, promovimin dhe përvetësimin e numrit sa më madh për këtë ide. Njëherësh, gjatë këtyre konsultimeve erdhëm gjer te përfundimi se ekzistojnë pengesa të shumta. Që para së gjithash kemi probleme me mediat, të cilat nuk janë të interesuara për atë se çka është e kaluara. Ata kanë raportuar për krime gjatë viteve kur ato krime kanë ndodhur, e sot nuk ekziston interesimi gazetaresk që për këtë të flasin dhe të raportojnë nga këto tubime. Nga ana tjetër nuk ekziston as interesimi i qeverive për tu marrë seriozisht me faktet mbi krimet e luftës. Ajo që e kemi arritur si një hap pozitiv ka qenë që shoqatat e viktimave dhe vetë viktimat kanë shprehur interesim të madh për realizimin e kësaj iniciative dhe se përkrahja më e madhe edhe vije mu nga këto shoqata, ndërsa përkrahja më e madhe, relevante, vjen nga radhët e organizatave të të rinjve. Kemi parë se problemi ekziston edhe në organizatat për të drejtat e njeriut brenda kornizave të shoqërisë civile, që organizatat e shumta nuk kanë kapacitetet e mjaftueshme, që janë të preokupuara me projektet e tyre vetanake e që shpeshherë janë aso projekte ashtu siç i propozojnë vetë donatorët, dhe që ka më pak aso projekte për statusin e të cilave duhet përpjekur shumë mes donatorëve. Dhe e kuptuam se ekzistojnë pengesa të shumta, por kryesorja është se kuptuam se ekziston përkrahja e numrit relevant të organizatave për të drejtat e njeriut, shoqatave të viktimave, shoqatave të veteranëve dhe organizatave të të rinjve. Neve tani jemi para një, ta përdorë këtë shprehje, lufte për përfitim për këtë iniciativë, mirëpo ne qysh tani jemi një numër i mjaftueshëm sa që ne, në bazë të përkrahjes që tashmë e kemi arritur, kemi formuar grupet

punuese të cilat do të veprojnë në të gjitha shtetet e ish- Jugosllavisë për përhapjen e konsultimeve, duke filluar që nga nivelet lokale. Gjithashtu kemi arritur gjer te përfundimi se kjo nuk duhet më të mbetet vetëm ide dhe iniciativë e këtyre tri organizatave të cilat e kanë iniciuar këtë ide, por duhet të formohet Koalicioni Rajonal, i cili do të përfaqësoj idenë për themelimin e Komisionit Rajonal. Dhe mu sot na ka arritur edhe konkludimi i grupeve punuese, që gjer në fund të muajit shtator të vitit 2008, do të merret pëlqimi i anëtarëve të Koalicionit Rajonal dhe të formohet ai dokument themelues për Koalicioni Rajonal, dhe ne me atë dokument dhe me nënshkrimet e organizatave të cilat po e përkrahin themelimin, do të dalim në Forum, në Prishtinë. E atëherë të fillohet procesi për pranim, për bashkëngjitje në anëtarësinë e Koalicionit Rajonal. Sot, gjithashtu kemi ardhur gjer te përfundimi se është më se e nevojshme një web-faqe, duke filluar nga shtatori, tetori; kur ai Komision Rajonal të filloj publikisht të merret me aktivitetet e veta, dhe lidhur me web- faqen, kemi konkluduar se do të kishte qenë mirë që një herë në muaj të kemi edhe news- letter (gazetën). Ajo që është e rëndësishme për këtë mbledhjen e sotme me ju, është se mu si në konsultimet e shumta të mëparshme, të cilat i kemi mbajtur, që ju të ndiheni të lirë për të folur, për të pyetur dhe për të propozuar në lidhje me këtë iniciativë. Do me thënë se nuk ka oratorë të parapërgatitur por të gjithë jeni të ftuar për të marrë pjesë, të komentoni, të propozoni, parashtroni propozime të reja dhe të mos e keni ndjenjën se këto janë paraprakisht të përgatitura, se edhe ky diskutim është i përcaktuar ose se përfundimet janë të nxjerra qysh më herët. Dhe ajo që ne presim, është që ju të kuptoni se të gjithë ne e kemi një obligim ndaj gjeneratave të ardhshme. Këtu, disa më pak e disa më shumë, e kanë këtë obligim. Ne, të cilët në vitin 1991, kemi parë se çka po përgatitet, e sidomos ne nga Serbia, e kemi një obligim të veçantë. Ne të cilët kemi tentuar të reagojmë me fjalë, të kundërshtojmë e nuk arritëm sukses, kemi obligim të veçantë që të angazhohemi maksimalisht, ashtu që të bëjmë diçka për gjeneratat e ardhshme të cilat nuk mbajnë kurrfarë përgjegjësie, por nuk mundemi që t'ua lëmë në trashëgimi vetëm krimet por duhet lënë edhe faktet, nuk mund t'ua lëmë varrezat e fshehta masive por duhet ti obligojmë dhe detyrojmë të gjithë ata të cilët posedojnë të dhëna për varreza të fshehta masive, për fatin e më se 17.000 të të zhdukurve në territorin e ish- Jugosllavisë, respektivisht ne duhet gjithsesi t'i detyrojmë të paraqesin të dhënat sepse është se e drejta në fakte mbi fatin e personave të zhdukur është e drejtë të cilën shteti ua ka borxh qytetarëve të vet dhe njësoj edhe çdo shoqërie tjetër i ka borxh të vërtetën mbi personat e zhdukur. Ne kemi aq shumë probleme në zbulimin e lokaliteteve, tani më me siguri veç varrezave masive, në të cilat janë varrosur mbetjet mortore, po në rast se ky Komision, përpos dokumentimit, përcaktimit të fakteve mbi krimet e luftës, do ta kishte për detyrë edhe hulumtimin e fatit të personave të zhdukur, atëherë ne do të kishim diç që gjer më sot ka arritur vetëm Komisioni për të vërtetën në Maroko. Ata, kanë përfunduar mandatin e tyre duke deklaruar se nuk kanë qenë në gjendje që të zgjedhin fatin e vetëm 57 rasteve që kanë mbetur pa zbuluar, nga numri i përgjithshëm prej 15.000 – 16.000 të të zhdukurve. Çfarë domethënie ka gjetja e mbetjeve mortore e personave të zhdukur? Unë vetëm do t'ua ilustroj me fjalët e një pjesëmarrësi të konsultimeve, e që është udhëheqës i Shoqatës së familjarëve të të zhdukurve nga Krajina dhe Kroacia, Qedo Mariq. Ai, në konsultimet në Podgoricë, ku kanë marr pjesë edhe Hysni Berisha, Lush Krasniqi e edhe disa tjerë të cilët sot nuk po i shoh këtu, po ai tha diç që ishte shumë pikëlluese për mua, është shumë vështirë të kuptohet, por në momentin që e kuptojmë atëherë na imponohet si obligim që ta lidhim fatin e të zhdukurve me këtë Komision Rajonal. Atij i është vrarë i biri, e ka patur një djalë të vetëm, dhe para pak kohësh atij i janë dorëzuar mbetjet mortore të të birit. Dhe ai, në atë tubim, thotë se është shumë i lumtur, se ka përjetuar lumturi të atillë që më në fund i ka marrë mbetjet mortore të të birit të tij, dhe që mundet ta varrosë, dhe ta dijë se ku është i biri ij, që

mund ta vizitoj atë, të flas e të bisedoj me të, dhe në fund i uroi fat në gjetjen e mbetjeve mortore të gjithë atyre që të cilët ende nuk i kanë gjetur. A nuk po e shihni edhe ju, ashtu siç e kuptova edhe unë duke e dëgjuar atë dhe duke lexuar fjalët e tij disa herë, se sa i tmerrshëm është fakti se çka është lumturi për prindin, për babanë, i biri i të cilit është vrarë. Ai më nuk ka shpresë për kurrfarë burgje të fshehta, për të është lumturi dhe ai do të rehatohet, dhe ai është i qetë, ka gjetur njëfarë prehje atëherë kur ia kanë dorëzuar mbetjet mortore. Po a është e tepërt që të kërkohet nga ato shtete që ta thonë të vërtetën, që atyre prindërve t'iu ndihmohet, atyre etërve, atyre nënave që më në fund pas aq shumë vitesh ta gjejnë njëfarë prehje kur mund ta dinë se ku fëmijët e tyre apo etërit gjenden, ku mund të vendosin ndonjë lule. E, kjo është ajo që në veçanti duhet të na motivoj dhe obligoj që ta përkrahim një iniciativë të tillë dhe të kërkojmë që të jetë prioritet i këtij Komisioni në zbulimin e fatit të të zhdukurve dhe zbulimin e varrezave të fshehta masive. Unë mendoj se ia kam arritur të parashtroj atë që ne po e bëjmë që dy vite e gjysmë dhe t'iu them që ne, të cilët marrim pjesë në këtë, jemi aq të vendosur për këtë iniciativë sa që mu tani me vetë përpjekjen ta përkrahim një iniciativë të këtij lloji, kemi bërë disa veprime të çmuara dhe gjëra, të cilat, sipas rregullës i takojnë mandateve të atyre Komisioneve për përcaktimin e fakteve.

Kështu organizata boshnjake Qendra për hulumtim dhe dokumentim, ka arritur ta përpiloj listën e personave të vrarë dhe atyre të zhdukur gjatë konflikteve të armatosura në Bosnjë dhe Hercegovinë, ashtu që ata sot i kanë dokumentet me emra dhe mbiemra, në të cilat janë të numëruar dhe të të emërtuar të gjithë ata të cilët kanë pësuar dhe humbur. Natyrisht, ata nuk kanë thënë se e kanë përfunduar regjistrin e përpiluar, edhe pas njëzet vitesh mund të paraqitet ndonjë emër të cilin nuk e kanë në regjistër, edhe kjo do të jetë e vlefshme. Ne, në Fondin për të drejtën humanitare, para dy viteve e kemi filluar regjistrimin e viktimave në Kosovë, dhe gjer më tani kemi arritur të evidentojmë, të regjistrojmë me emër e mbiemër, dhe me të dhënat të cilat tregojnë rrethanat në të cilat dikush është vrarë, pësuar ose humbur, rreth 12.000 viktima. Ajo që e bën këtë regjistrim të dalloj nga ai në Bosnjë, është se, atje ka 100.000 të vrarë dhe të zhdukur, e në këtë rast është numri shumë më i vogël, prandaj do të arrijmë sukses që për çdo viktимë të kemi një përshkrim të shkurtër të jetës së tij dhe rrethanave në të cilat është vrarë apo pësuar. Kjo është me rëndësi. Është e rëndësishme, sepse me kohë humben të dhënat. Është me rëndësi të kemi diçka të qëndrueshme, është e rëndësishme që secila shoqëri të ketë faktet në bazë të të cilave do të ekzistojë ajo kujtesë kolektive shoqërore, është e rëndësishme për shkak të atyre viktimave që më nuk janë, është e rëndësishme për shkak të gjeneratave të ardhshme. Atë regjistër, të cilin e ka bërë qeveria boshnjake, të cilin po e bëjmë tash për Kosovën, natyrisht në Serbi po duam ë të regjistrojmë të gjithë ata vullnetarët, policët, ushtarakët rezervë të cilët kanë marrë pjesë në konfliktet e armatosura dhe janë vrarë, pësuar diku në territoret e shteteve tjera, e jo në territorin e Serbisë. Në këtë mënyrë do të përmirësojmë dhe ndërprejmë përvojën e cila po zgjatë në këto treva, e kjo është që as sot e kësaj dite nuk dihen varrezat e atyre të cilët janë vrarë pas luftës së dytë botërore. A duam që për gjeneratat e ardhshme të mos jenë trashëgimi vetëm krimet, por që të trashëgojnë edhe faktet në mënyrë që ata vetë pavarësisht të konkludojnë se çfarë ka ndodhur, dhe gjithnjë të jenë të gatshëm të kundërshtojnë, para së gjithash, me fakte tentimet që të kthehet e vjetra a . Dhe ju lutem, ndihmoni në këtë iniciativë sepse, sado që këtu të ketë njerëz të cilët kanë humbur më të afërmit e tyre, të cilët ende nuk kanë arritur gjer te njerëzit e tyre, është shumë, shumë e rëndësishme, të bëhet gjithë çka është e mundur për viktimat të cilat janë në numër të madh, kurse sot, ne vetëm po i përmendim, ose politikanët i përmendim vetëm kur kanë ndonjë aktivitet politik, zgjedhjet dhe pas atyre të gjithë i harrojnë. Dua vetëm t'iu them, për shembull, ju të gjithë jeni të njoftuar për viktimat e Srebrenicës, ata të gjithë bëhen shumë të rëndësishëm më 11 qershor, në ditën e përvjetorit të masakrës, gjenocidit në

Srebrenicë, e pas saj e dini se vetëm ku mund ti gjeni, janë vetë aty ku ata jetojnë. Shumë prej tyre (viktimave) ende jetojnë në qendrat kolektive, shumica jetojnë në ndonjë dhomë të marrë me qera, shumica jetojnë me nga 50 euro në muaj, disa edhe më pak ,dhe këto nuk janë viktimat, të cilave shteti u ka ndihmuar në ndonjë mënyrë, që t'iu bëj me dije se ata janë të rëndësishëm. Ata jetojnë të mjerë, të poshtëruar dhe, nëse ne në këtë mënyrë ia arrijmë që çështjen e viktimave ta ngrisim si të rëndësishme, si çështjen më të rëndësishme politike dhe demokratike në rajon, atëherë ne kemi arritur sukses për të bërë diçka për të gjithë ata që sot nuk janë. Faleminderit.

Vesna Tersheliq: Faleminderit Natasha. Ju kisha lutur për komentimet, propozimet e juaja, dhe pasi që jemi në numër më të madh, thjesht do t'iu jap fjalën sipas radhës me të cilën do të lajmëroheni, dhe ju lus që kur të filloni, të prezantoheni përsëri në mënyrë që të kemi edhe emrin në transkript lidhur me intervenimet. Ja, dora e parë, urdhëroni.

Afrim Caka: Po e përsëris edhe një herë, quhem Afrim Caka nga Gjakova, ish i burgosur politik dhe i mbijetuar i masakrës së Dubravës. Si shumica e prezentëve këtu, nuk mund të imagjinoj se çka ka ndodhur në masakrën e Dubravës dhe në qytetin e Gjakovës. Unë njëherit jam edhe autor i librit me 1870 faqe. Ky libër është kryesisht i bazuar në dëshmi, dhe kam vizituar rreth 4000 shtëpi, dhe kam marrë dëshmi nga të gjithë pronarët, nga gjitha shtëpitë që kanë përjetuar masakrën, ose më mirë të them, ferrin serb. Unë, si ish i burgosur politik, jam munduar edhe vetë sa të mundem të hedh dritë mbi masakrat e kryera në Gjakovë dhe në burgun e Dubravës. Sa kam qenë në Burgun e Nishit, kam mbajtur ditar, dhe ato i kam përcjellë me mjeshtri të madhe përmes gruas sime në Gjakovë. Të gjitha sot i kam në formë të shkruar si “Ditar i Burgut”. Prandaj edhe shumë shpesh ka ndodhur që letrat e mia të përfundojnë në duart e sigurimit. Unë, nëse më lejoni, i kam nxjerrë disa fragmente nga Ditari i Burgut, besoj se do të keni durim dhe do të më jepni të drejtën të lexoj sadopak. Në radhë të parë, do ta përshëndes posaçërisht Natasha Kandiqin, e cila ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm pas luftës në Gjakovë, sidomos gjatë rebelimit në burgun e Nishit. Unë këto fragmente i kam nxjerrë nga libri, edhe disa foto i kam sjellë nga masakra e Dubravës, dhe të gjitha këto që i kam shkruar dhe gjitha fotot që i kam sjellur nuk i kam sjellë për të krijuar urrejtje, por përkundrazi, drejtësi. Pasi që qeveria e jonë, e përparshmja, e dhashtë zoti edhe kjo e tashmja, dhe UNMIK-u nuk ndërmoren edhe hapin më të vogël për t'i ndriçuar rastet dhe sadopak për t'i kapur kriminelët që morën pjesë në masakrat në këto krime të shëmtuara. Në mesin e tyre ka pasur serbë, malazezë, bashkëpunëtorë shqiptarë, romë... unë në radhë të parë do të nisem nga arrestimi, do të përmendi disa emra. Pastaj shpresoj që zonja Kandiq do të më japë një përgjigje, dhe si mund të vijmë tek kallëzimet penale, megjithëse ne si shoqatë jemi duke bërë përpjekje maksimale për të bërë një kallëzim penal në Strazburg, në Gjykatën për të Drejtat e Njeriut. Gjithë e dimë që pjesa dërmuese në Burgun e Dubravës kemi qenë nga Gjakova, ku aty janë vrarë 9 dhe janë plagosur mbi 47. për fat të mirë unë kam pësuar një plagë të vogël, por të rënët kanë mbetur pas. Në Burgun e Dubravës kanë qenë 980 shqiptarë, nga burgun kanë dalë 720 vetë, pra mbi 260 vetë të vrarë. Unë mundem, për kureshtjen tuaj, këto foto janë të të masakruarve në Burgun e Dubravës, kjo është korridori i ambulancës, kjo është një korridor tjetër, këtu është një grumbull tjetër i shqiptarëve të vrarë, këtu shihet Boban Bashqeviq, ka qenë një kriminel ordiner i cili ka marrë pjesë drejtpërsëdrejti në masakër. Këtu shihet Pavijoni pas bombardimit, këtu është një rreth i vogël, një kokë shqiptari, këtu janë disa grumbuj shqiptarë të mbuluar me batanije, këtu janë disa kufoma shqiptarësh pa këmbë, pa duar, me organe të nxjerra jashtë, këtu shihet qartë Ilia Mishqeviq nga Çaçaku, ky sot jeton dhe punon në Çaçak. Këto janë disa kufoma tjera të mbuluara me carcafë të bardhë dhe batanije, të cilët nuk kemi arritur t'i mbulojmë, sepse kanë qenë të nakatosur. Boban Bashqeviq, shihet me pistoletë dhe automatik pranë kufomave shqiptare, këtu shihet Napolon

Guta, Përparim Efendiu, Nikollë Berisha dhe Halil Guta, duke bartur Napolonin e plagosur, pas disa minutash, policia dhe paramilitarët i vrasin në prezencën e tyre, Ilijas dhe Bobanit, vritet Napoloni dhe ky Nikollë Berisha, napoloni nga Gjakova. Këtu shihet Napoloni i plagosur, por ende gjallë, këtu shihet Napoloni dhe Përparim Efendiu në prezencën e Boban Bashqeviqit me automatik të fshehur prapa shpine, duke u sqaruar me paramilitarët serbë, për fat të mirë, këtu gazetarët grekë dhe francezë, kanë shpëtuar edhe këta dy, Përparimi edhe Halili, vëllau i Napolonit. Këtu është shoku i një dhome në Dubravë, Besnik Kastrati, i cili është vranë dhe është prerë përgjysmë, shihen organet e nxjerra. Këtu shihet një kufomë tjetër shqiptare, këtë foto e ka bërë Xheki Rolan, disa të burgosur shqiptarë që kanë arritur të ikën nga burgu. Ata janë zënë jashtë burgut dhe janë masakruar, këta kanë qenë mbi 20-30 vetë, sepse nuk kemi pasur mundësi t'i numërojmë saktësisht. Këta kanë qenë me këmbë të thyera, organe të nxjerra jashtë, sytë të nxjerrë, brinjë të thyer, në kokë kanë qenë më të ngushtë. Prandaj, unë, nëse më jepni të drejtë, do të mundohem të lexoj disa emra, të cilët janë marrë me të burgosurit gjakovarë. Prej Gjakovës, me ne është marrë Dragan Milicko Mihajloviq, ky ka qenë malazez, sot jeton në Nish. Po flas për momentin kur kemi të qenë të mbyllur në Gjakovë, në punëtorinë e Nazmi Ramë Kurtit, të cilin kur kemi hyrë brenda, kemi parë njolla gjaku, rroba, rroba intime, e shami. Pas ca kohe, kanë ardhë Koloneli Milovan Hoqeviq nga Novi Sadi, ky ka qenë komandant i SPB-së Gjakovë, bashkë me serbin Rade Nikolitiq nga Peja. Objektin e Nazmi Ramë Kurtit, e kanë ruajtur Dragan Velicko Mihajloviq, Vladan Velicko Mihajloviq, Tihomir Gjorgje Rajqeviq, Bogoljub Anxhelko Saviq, serbi tjetër Zvonimir Gvozdan Pavloviq, nga fshati Vraniq i Gjakovës. Me ta ishte edhe një shqipfolës nga Batusha e Gjakovës, Muharrem Mahmuti, i lindur në Sarajevë, dhe birësuar nga Muharremi. Këta janë atë që kanë bërë roje, kanë vranë dhe kanë plaçkitur. Me 11 maj policia, mund të them lirshëm, hierarkia e shtetit kriminel serb në Gjakovë, në krye me Rade Milovan Mihajloviq, të gjithë kanë qenë përgjegjësit kryesorë për të gjitha ato krime të shëmtuara në Gjakovë, dhunime, plaçkitje, djegie. Dihet se Gjakova është e para në Kosovë për vrasje, plaçkitje, dhunime e djegie. Në Komunën e Gjakovës janë djegur mbi 1800 shtëpi, 800 dyqane, dhe janë plaçkitur mbi 92% e shtëpive shqiptare. Këta, Rade Milovan Vlahoviq nga Deçani, Rade Milenko Mikiq nga Peja, Nenad Zhivka Jakiq, Ljubisha Andrija Jovanoviq, Milovan Jakiq, dy vëllezërit Xhukica e Bodimir Stojanoviq, ky ka qenë edhe kryetar komune gjatë luftës në Gjakovë, dhe tash është zgjedhur prapë kryetar komune dikund në Jagodinë. Me ta ka qenë edhe vëllai Milan Bodimir Stojanoviq, nga Gjakova, Lazar Sava Draskoviq, ky ka qenë rom serb nga fshati Zub, Klinë, Milan Miomir Slavkoviq, serb, edhe Nikolla Camoviq, ky ka qenë zëvendës i Milovan Kolasheviqit, në SPB në Gjakovë, ka qenë i Sigurimit Shtetëror. Ky ka qenë i fshatit Proskot, Podgoricë, por ka jetuar gjatë në Gjakovë, pra është nga Mali i Zi. Me ta ka qenë malazezi Slobodan Savko Kovaç, me siguri Kandiq ka mundur ta vërejë, sepse ka qenë dëshmitar në procesin e montuar në Burgun e Nishit, në të cilin janë dënuar me 1632 vjet. Me ta ka qenë edhe Pavle Milorad Radeviciq, nga Gjakova dhe një oficer serb nga Nishi, të cilin nuk kam arritur t'ja mësoj emrin. Të gjithë këta i kanë marrë të burgosurit politikë, pra të arrestuarit, dhe i kanë dërguar në SPB, janë rrahur, janë maltretuar, janë plaçkitur, dhe kanë ardhë me dhëmbë të thyer, brinjë të thyera dhe të gjakosur. Këta pra janë ata arkitektët kryesorë të rrahjes, të cilët na kanë ngritur aktakuzën për "terrorizëm".

Vesna Tershelliq: Vetëm ju kisha lutur që pak ta shkurtoni, që edhe të tjerët të kenë pak kohë.

Afrim Caka: Për këtë edhe kam ardhur, të lexoj së paku disa emra, të cilët kanë marrë pjesë në këto krime. Do t'ju lusja, nëse më jepni kohë, të lexoj, nuk ka shumë, edhe tri lista. Këta kanë qenë ata. Nga Burgu i Pejës, nga Gjakova, na kanë dërguar në Burgun e Pejës, prapë me maltretime, rrahje, do të thotë, 7 ditë e net nuk kemi ngrënë as pirë. Nga Peja me autobus na ka

përcjellë në autobus Nuho Andrija Raqiq, nga Gjakova, dhe në përcjellje të këtij autobusi dhe disa kamionëve të tjerë kanë marrë pjesë: malazezët Dragan Velicko Mihajloviq, Vladan Velicko Mihajloviq, dy vëllezër, malazezi tjetër Slobodan Savko Kovaç, serbi Dushan Vekiq nga Hoça e vogël, Rahovec, dhe Muharrem Botusha nga Botusha. Kështu, më 18 kemi hyrë në Burgun e Dubravës. Më 18 kemi hyrë në Burgun e Dubravës, siç e di edhe Zonja Kandiç dhe Fondi Humanitar, Serbia i ka sjellë e i ka tubuar të gjithë të burgosurit shqiptarë nga të gjitha burgjet tjera të Serbisë. Jo vetëm për t'i pasur në dorën e tyre dhe nën këmba e policisë, por edhe për vrasjen e tyre, dhe për të fajësuar Aleancën e NATO-s për këto vrasje. Serbia kishte njohuri se Burgu i Dubravës do të bombardohej, nga cila kanale informohej nuk e di me saktësi, por me sytë e mi kam parë se si Serbia po planifikonte një holokaust të ri. Me datën 21, në Burgun e Dubravës kanë ardhë të njëjtat kriminelë që kanë marrë pjesë në krimet e Gjakovës, pra Milovan Miloje Vrškiq nga Komuna e Klinës, Dragan Spasoje Shqepanoviç, malazezët Slobodan Savko Kovaç, Milan Jakiq, serbët Gjokica Budimir Stanojeviq, Rade Milenko Nikiq, Nenad Zhivka Jakiq, këta kanë ardhë në Dubravë për t'i marrë gjakovarët në pyetje, ose më mirë të them për t'i ngritur aktakuzat për terrorizëm. Për fat të mirë, NATO-ja bombardon objektin e Drejtorisë, ku e them edhe një herë, për fat të mirë nuk lëndohet asnjë shqiptar por vritet një gardiane, një femër serbe dhe dy gardianë. Rreshtimi dhe ekzekutimi më masiv dhe më makabër ndaj shqiptarëve në Burgun e Dubravës, 22 maj, 5 e 45 minuta. Të burgosurit gjatë luftës duhet të jenë domosdo nën mbikëqyrjen e shtetit pasi trajtohen si popullatë e pambrojtur. Masakra e Dubravës dhe vrasja në masë e shqiptarëve të marrë peng e të pambrojtur është dëshmia më e prekshme dhe më transparente e mungesës së kujdesit shtetëror. Vdesin 3 njerëz në aksident diku në botë, dhe e tërë bota e përjeton emocionin përmes mediave. Është krejtësisht njerëzore. Është krejtësisht njerëzore që njerëzit të ndajnë mes vete emocionet dhe solidaritetin. Por, para 7 gjejësisht 9 vitesh, në ishullin e tragjedisë, në Burgun e Dubravës, ndodhi masakra më e tmerrshme, e përmasave mitike, dhe askush deri më sot, as ata që vranë para syve të të burgosurve, edhe ata që panë, nuk e thanë edhe një fjalë të vetme keqardhjeje, e aq më pak ndonjë akuzë ndaj atij krimi të shëmtuar të kryer nga shteti kriminal serb. Vallë, a është e mundur që njeriu të veprojë e të mendojë si ka qejf? Gjenerali De Gol e ka pasë një thënie të mirë. “Sa më shumë i njoh njerëzit, aq më shumë i dëshiroj kafshët”. Masakra e Dubravës është pasqyra më e vrazhdë e shkeljes së normave elementare të drejtësisë njerëzore, ndërkombëtare dhe asaj shqiptare, e cila edhe më tutje neglizhohet nga faktori vendas. Çuditërisht, Kuvendi i Kosovës sikur nuk e gjen momentin e përshtatshëm për ta shpallë formalisht si një kamp përqendrimi Burgun e Dubravës, në të cilin janë torturuar, dhunuar, masakruar dhe fyer shqiptarët. Kjo do të ishte një satisfaksion për mua. Mandej, hapi i parë i gabuar që nuk mund të falet është vetë rindërtimi i burgut të Dubravës, duke e privuar Kosovën në përgjithësi nga njëri ndër monumentet e rralla të portretizimit të manisë patologjike kriminale të një shteti, me formate më të terrshme të një holokausti të ri. 22 maj – kjo është më e rëndësishmja, se si ka ndodhë masakra më e tmerrshme ku janë vrarë për 30 sekonda mbi 110 vetë. E shtunë, ora 3 e mëngjesit. Ne ishim duke bërë gjumë në terrenet e sallës sportive, gjumë ndoshta jo por mundoheshim të siguronim vetveten, aty ishin tubuar mbi 500 apo 600 veta. Në vëzhgimoren numër 5 që e kishim afër kishte hipur Svetlan Matanoviç, i dënuar më parë për vrasjen e familjes Cacaj në Deçan, ky ishte i ardhur nga Vrraka, Shkodër, Shqipëri. Emri i tij i vërtetë ishte Dritan Spiro Pjetri, bënte roje dhe vëzhgonte lëvizjet e të burgosurve, prapa mureve të burgut. Paramilitarët ishin duke bërë përgatitjet për ekzekutimin më masiv dhe më makabër ndaj shqiptarëve. Krimineli Svetlan Matanoviç alias Driton Pjetri, nga Vëzhgimorja nr. 5 thërret me zë të lartë që sa më shpejt të rreshtohemi dhe të shkojmë në Burgun e Nishit. Aty nuk ishte vendi për t'u rreshtuar për të shkuar në Nish. Pas 2-3 sekondave, ky Svetlani mbante në

dorë një pushkë me dylbi snajperi. Pas 3-4 sekondave, futet në vëzhgimore dhe merr një minahedhës dore “Zola” dhe godet në mesin e të rreshtuarve. Pas disa të qindtave të sekondave, filluan granatimet me minahedhës, me dylbi snajper, mitraloza të rëndë, bomba dore, pistoleta, me gjitha llojet e armëve. Në Dubravë, mbetëm në mes të gjithë si gladiatorë të vdekjes. Dubravën e kthyen në laborator kufomash, kudo të vdekur e të lënduar rëndë. Pjesë të trupit të shpërndara në tërë fushën... nga granatimet u spërkata në fytyrë e në trup me gjakun e të plagosurve. Vendi u mbulua me kufoma e pellgje gjaku. Nga tmerri një pjesë e të burgosurve ranë në gjendje shoku. Bilanci ishte diku mbi 110 vetë, mbi 300 e ca të plagosur lehtë e rëndë. Ne filluam të vraponim në drejtime të ndryshme, pa marrë frymë, e s’dinim kah t’ia mbanim. Përfunduam në kuzhinë. Nga dera kryesore u futën gardianët dhe kriminelët ordinerë serbo-malazezë e civilë, të armatosur dhe të maskuar, e disa edhe pa maska, me armë, bomba dore, thika, pistoleta, automatikë. Këta bënë gara se kush po vret më shumë shqiptarë. Kudo kishte kufoma të shqiptarëve të vrarë ditë më parë. Kufomat kutërbonin erë të rëndë, sepse ishin vrarë disa ditë më parë. Vrapuam në drejtim të kuzhinës, Ilir Damonaga ma bënte me dorë, eja se këtu është më sigurtë. Nga Vëzhgimorja nr. 3 kriminel i ordiner, i veshur me tesha të gardianëve, me pushkë-dylbi-snajper, e qëllon Ilirin në kokë me pushkë. Ky është Aca Paviqeviq nga Mali i Zi. Kurse nga Vëzhgimorja nr. 5 gardiani e qëllon për vdekje Muhedin Xhelal Gutën. Kudo kufoma të përgjysmuara, i gjithë terreni kundërmonte erë të rëndë. Kufomat ishin të 20 orëve më parë. Dy veta bënë vetëvrasje, njëri ishte nga Ferizaj, vetëm për të mos rënë në dorën e kriminelëve. Të plagosurit tjerë kishin mbetur në vend dhe luteshin t’i linim aty për t’ju dhënë fund vuajtjeve, edhe ata do të vriteshin.

Natasha Kandi: Ju lutem, më duhet të ju ndërpres. Ja çfarë unë propozoj. Ne i kemi dy orë në dispozicion. Veç kanë kaluar një orë e pesëmbëdhjetë minuta. Ajo që ka ndodh në burgun e Dubravës është aq e tmerrshme, dhre komplikuar, propozimi im është siç vijon: ne të merremi vesh për muajin tetor kur edhe do të mbahet ai Forum, një ditë është e parashikuar për dëgjimin publik të viktimave, dhe që ju të përgatiteni për atëherë, por të flisni për atë që ju e keni parë atje, jo se çfarë ka ndodhur, por për atë që ju e keni parë. Për ato ngjarje të datës së 19, 21 dhe 22 majit. E mandej presim që të flisni, shikojeni atje Ukshin Hotin, unë gjer në detale e di se për çka po flisni ju, vetëm se nuk i di me emër. Por, ajo që po ju lutemi për sot, është që të shohim se çka mundemi, për shembull, të bëjmë lidhur me këto raste, siç janë krimet e kryera në të burgosurit e Dubravës. A mundemi që këto ti dokumentojmë para formimit të këtij Komisioni Rajonal, përgatisim të dhëna të mjaftueshme për ndjekje penale që nga udhëheqësi i burgut, Aleksandri, nuk po më kujtohet tani për tani mbiemri i tij, përndryshe ai tani ndodhet në Serbi. Të përpiqemi, ashtu siç edhe me rastin e fshatit Tërm, ku kemi mbledhur të dhëna për krimet e kryera, por kjo është një punë serioze, e dini se sa po punojmë në këtë rast.

Afrim Caka: Aleksandar Kovaçeviq, drejtori i burgut në Dubravë, Zhivkoviq Zharko, zëvendës drejtori, e ky....

Natasha Kandi: Nuk është Zharku. Jo, nuk është..

Afrim Caka: Zhivkoviq Zharko.

Natasha Kandi: Po nuk është ai zëvendës.

Afrim Caka: Aleksandar Kovaçeviq është drejtori i burgut në Dubravë.

Natasha Kandi: Nuk është Kovaçeviq, nuk e ka mbiemrin Kovaçeviq. Nejse, hajde, nuk është me rëndësi, të gjitha do ti...

Afrim Caka: Zhivkoviq Zharko është zëvendës drejtori.

Natasha Kandi: Desha të them se nëse vazhdojmë kështu, ne do të mund të paraqesim vetëm edhe dy raste...

Afrim Caka: Ja, ky është komandanti i burgut në Dubravë, Miroljub Miki Vidiq....

Natasha Kandi: Po ky është Miki Vidiq, nuk ka qenë komandant i burgut, por ka qenë komandir i rojes.

Afrim Caka: Si, ai kur ka hyrë në qelinë time, ka thënë: ‘‘ Unë jam komandir i burgut në Dubravë’’ unë kështu e di, kështu ai më është drejtuar në burg.

Natasha Kandi: Mirë, nuk është ai komandir, ai është Miki Vidiq, mirëpo të merremi vesh ose të mos presim kurrfarë komisioni po ti mbledhim të gjitha të dhënat, të përgatisim kallëzimet penale por, kjo do të thotë se atëherë edhe ju, të burgosurit tjerë, duhet të angazhoheni shumë. Krahës kësaj, do të thotë se ky vendim varet nga ju, mirëpo, atëherë duhet që me shumë seriozitet, detalisht dhe me shumë saktësi të mbledhim të gjitha të dhënat. Diçka tjetër, që mendoj se është me rëndësi, në atë Forum, kur të kemi dëgjimet publike, është që atëherë të përgatisim që në mesin e viktimave që do të flasin të jeni edhe ju, ose ndokush tjetër, po kjo do të thotë se rasti nuk duhet të prezantohet ashtu siç e bëtë ju sot, por të flisni vetë për ato që i keni parë vetë, ato që keni parë të kenë ndodhur aty, për ato që i keni parë drejtpërsëdrejti dhe keni mundur të shihni, mund të cekni edhe ato që i keni dëgjuar por gjithsesi duhet ta cekni saktësisht që të dihet nga kush dhe çka. Është mirë që të shihet se a pajtohen të gjithë apo jo për shkak se aty do të dëshmojnë viktimat nga e gjithë ish- Jugosllavia, nga Kroacia, Bosnja, dhe Serbia me Kosovën, dhe romët, nuk do të mund të jetë e mundur, që, për shembull, të mund të dëshmojnë ë tepër se dhjetë prej tyre, brenda një dite. Të shohim se cilët janë më të mirët. Unë, personalisht, mendoj se do të ishte mirë të jetë aty ndokush nga Gjakova, nga Qabrati, ose të ftojme dikë që mund të dëshmojë se çfarë ka ndodhur në Taliqmost, ose në Gjakovë, ku kanë ndodhur shumë gjëra të tmerrshme, e më pastaj të merremi vesh se cilat do të jenë ato raste që do të paraqiten, kush do të dëshmojë për ato. Mirëpo sot do të flasim për kontekstin në vazhdim. Duke pasur parasysh Dubravën, Qabratin, duke marrë parasysh Vushtrrinë, Mitrovicën, duke pasur parasysh se farë ka ndodhur pas qershorit të vitit 1991, të bisedojmë për atë se në çfarë mënyre, a është ky Komision Rajonal, a do të mund të na ndihmojë, a e sheh edhe ndokush tjetër se çfarë tjetër mund të ekzistoj përpos gjykimit, përpos një komisioni të tillë rajonal, se si të arrihet gjer te e vërteta, si do të arrihet gjer te ajo që ta kuptojmë se çfarë ka ndodhur në Dubravë, Qabrat.

Afrim Caka: Një fotografi vlen më shumë se tre mijë fjalë, ja shikojini...

Natasha Kandi: E di unë për këto fotografi. Këto fotografi ekzistojnë edhe në internet.

Afrim Caka: Unë tash nuk e di, unë kam ardhur për të ju ndihmuar, të përmend emrat e njerëzve të cilët drejtpërsëdrejti kanë marrë pjesë në krime, ata njerëz sot shëtisin lirisht në veriun e Mitrovicës, në Beograd, në Serbi dhe në Mal të Zi.

Natasha Kandi: Mund të përgatisim kallëzime penale kundër tyre.

Afrim Caka: Të ju them të drejtën, unë nuk kam besim në gjykatat e Serbisë. Unë, si të them, do të mund të shkoja në secilin vend, në çdo shtet, por në Serbi jo. Kush do të më mbroj mua atje? Ai gjykim nuk mund të zgjat një javë. Unë mendoj se ky gjykim duhet të mbahet në Kosovë, e jo në Serbi. Ai duhet të vij këtu para drejtësisë shqiptare.

Natasha Kandi: Prisni, prisni, ejani të lutem që të sqarohem. A mund ta paramendoni situatën ku një udhëheqës i burgut të vij këtu në Kosovë që të gjykohet!

Afrim Caka: E pse jo? Përse ju po i burgosni shqiptarët për atë që kanë bërë diçka para dhjetë viteve, e serbet të cilët kanë vrarë...

Natasha Kandi: A keni parë ju që gjykata të ketë liruar ndonjë shqiptarë? A keni parë, a keni dëgjuar?

Afrim Caka: Të ju them të drejtën, unë tani nuk mund të merrem me politikë...

Natasha Kandi: Sinan Morina është liruar.

Afrim Caka: Vetëm me ata që kanë kryer krime e gjykata e ka fjalën e vet. Unë kam thënë më parë por do them edhe njëherë. Unë e kam shkruar një libër, i cili i ka 1.570 faqe, dhe të gjitha janë aty, të dhënat janë marrë nga ata që kanë qenë prezent gjatë kohës së masakrave, në kohën e vrasjeve, dhunimeve dhe të gjitha tjerave.

Natasha Kandi: Të ju them, librat janë shumë të rëndësishme, por nuk ka asgjë më ekzakte, më të saktë, ta them nuk ka asnjë mënyrë më të saktë që diçka të prezantohet në opinion, se sa që është gjykimi. Unë, në Serbi, në të gjitha gjykimet për krimet e luftës i përfaqësoj viktimat. Momentalisht, po mbahet gjykimi për krimet të cilat janë bërë në Suharekë. Është mbajtur gjykimi për vrasjen e katërmëdhjetë grave dhe fëmijëve në Podujevë. Kanë dëshmuar ata fëmijë, tani po dëshmojnë në gjykimin për Suharekë, po dëshmojnë ata që kanë mbijetuar. Gjykimet për krimet e luftës në Serbi janë shumë profesionale. Në këtë moment, sipas vlerësimit tim, këto janë gjykimet më të mira në tërë rajonin, për arsye se ne, si Fond për të drejtat humanitare, jemi në gjendje të sigurojmë, të sjellim të gjitha viktimat. Gjykimet i përcjellin edhe familjarët, dhe më besoni për këto që po ju them, se është shumë e rëndësishme që të sillen para drejtësisë, ata që i kanë kryer këto krime të luftës. E pastaj ta luftojmë...sikur të kishim pasur kohë të ju përcjellim se si duket lufta jonë për përcaktimin e të vërtetës për ngjarjet në fshatin Tërm. Po të mos ishte Bekim Berisha, i cili ka mbijetuar, të cilit ia kanë vrarë katër motra dhe nënën, po të mos ishte... ai është asi luftëtari, po të ishte në gjendje, ai nuk di serbisht, ai në shkurt të këtij viti ka dëshmuar publikisht në Beograd për atë që ka ndodhur. Kjo, e kjo është lufta për të vërtetën, kjo është lufta për dinjitetin njerëzor të viktimave. Duhet të thuhet atje ku janë kryerësit, duhet të jesh i guximshëm dhe të mendohet për ato viktima dhe të flitet. Sot, të gjithë ata që e kanë mbijetuar atë Dubravë, dhe burgjet në Serbi duhet të flasin, e ne, sot do të bëjnë çdo gjë që kjo e vërtetë të mbetet në kujtesë, që ajo e vërtetë të jetë e pranuar para gjykatës, që atë të vërtetë ta dinë të gjithë qytetarët e Serbisë. Përndryshe nga ajo, që ju, këtu në Kosovë, do të tregoni në televizion, nga ajo që njerëzit edhe njëherë do ta thonë: “po kjo është e tmerrshme se çfarë ka ndodhur”, por nuk ka asi drejtësie e cila mund të sigurohet këtu në Kosovë, pasi që kryerësit dhe qeveria, të cilët janë përgjegjës për këto gjenden në Serbi, atje duhet ti thoni këto.

Afrim Caka: Unë do të thosha edhe diçka. Pasi që lënda jonë e grupit të Gjakovës akoma gjendet në shkallën e parë, do të thotë se ne ende jemi nën hetime. Unë kam dëgjuar, unë i kam pasur disa kërcënime me vdekje nga serbet nga Serbia dhe nga disa shqiptarë të cilët kanë qenë lojal ndaj këtyre kriminelëve, të cilët tani jetojnë në Kosovë, unë do tui lutesha, nëse më lejoni, tu lexoj edhe dy- tri fjali.

Natasha Kandi: Ju lutem, zotëri Caka. Eja e na ndihmo neve. Unë po i shoh këtu edhe shumë njerëz të cilët do të mundeshin të tregonin edhe gjëra më të këqija se që është Dubrava. Ju sigurisht e dini se çfarë ka ndodhur në Qabrat, ju e dini çka është...

Afrim Caka: Aty është shtëpia ime tani.

Natasha Kandi: E, atëherë ju, kur jeni burgosur, 7.apo 10/05/1999.

Afrim Caka: Jemi prej 7 maj gjer më 12 maj.

Natasha Kandi: Po, por ejani e na ndihmoni që secili këtu të mund të thotë, të shohim se si do të dokumentojmë rastet siç janë Dubrava, se si do ti paraqesim këto në opinion, se si të arrijmë gjer te ajo që ta dinë të gjithë ata që duhet ta dinë. Si do ti paraqesim viktimat në opinion që ata të mund të flasin për këtë. Le të shohim se çfarë do të bëjmë edhe me raste tjera. A do të, e edhe kjo është pyetje për juve, a keni menduar se cila është mënyra që të ruhet kujtesa për atë se çfarë

ka ndodhur në Dubravë, cila është mënyra për dënimin e kryerësve, cila është mënyra që të gjithë të dinë për atë se çfarë ka ndodhur. A është ky vetëm libri juaj, a është kjo vetëm bisedë në sallë të mbyllur, a është shumë më e rëndësishme se kjo formimi i Komisionit Rajonal i cili do të merret me këtë, a është gjithashtu e rëndësishme që të mblidhen të dhënat, të përpilohet kallëzimi penal dhe të luftohet që ata kryerës të nxirren para gjykatës.

Afrim Caka: Sigurisht se ju, Natasha Kandiç, keni dëgjuar për Ana Frankun dhe ditarin e Ana Frankut. Ajo ka qenë tri vite në tavan dhe nga dritaret e vogla ka parë se çfarë kanë bërë gjermanët, e ai ditar...

Natasha Kandiç: Jo, ju lutem Zotëri Caka, kemi gjithsej vetëm edhe një orë e gjysmë kohë. Lejoni që edhe të tjerët të flasim, por do të mundemi... ja, do me thënë, unë këtu i kam paraqitur dy propozime konkrete. Të përgatisim rastin e Dubravës për Forumin Rajonal në fillim të tetorit, në Prishtinë, të flisni ju apo dikush tjetër i cili është nga ai burg, por të flisni në vetën e parë, për atë se çfarë i ka ndodhur atij dhe çfarë ka parë ai. E që pastaj, njëkohësisht, që të gjitha ato që ju i keni, të tentojmë të përpilojmë kallëzim penal. Ja, unë do ta lus Hysni Berishën që në pauzë të ju tregoj se si duket kjo, ose të bisedoni me Bekim Gashin me Tërmi, të shihni se çfarë ka bërë ai që të vije në gjykatë. Këtë që po e thoni, unë nuk e di, drejtësia këtu është ose nuk është...gjykata është gjykatë. Gjyqi është i mirë aq sa i bëhet presion që gjykatat duhet të punojnë në pajtim me ligjin dhe pastaj nuk ka frikë...Po pritni, atëherë si u është gjykuar në Hagë, jo atje ku janë kryer krimet po atje ku është themeluar gjykata. Është e rëndësishme që krimet e luftës, për ballafaqimin me të kaluarën, të gjykohen aty ku janë kryerësit. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që gjykatat serbe të gjykojnë shtetasit serb, të gjykojnë policët serb. A mendoni se nuk është e rëndësishme tani, që për krimin në Suhareke Reci, që ndihmës komandantit të xhandarmërisë ti gjykohet në Serbi. Mendoj që kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme. Ky është pra demaskim i asaj policie si një polici e cila është e mirë, paraqitje që dikush që është ndihmës komandant i akuzuar për krime lufte sipas përgjegjësisë komanduese, që në Suharekë kanë ndodhur asi lloj krimesh në të cilat ka qenë e përfshirë edhe policia, ka qenë i përfshirë ndihmës komandanti i xhandarmërisë. Atëherë kjo do të ketë kuptim. Por, ju lutem, ndihmoni, vendosni për atë që të shohim se në çfarë mënyre do të luftojmë për të vërtetën, për ngjarjet që kanë ndodhur në burgun e Dubravës. Për atë, edhe sot e kësaj dite, askush nuk e di se çfarë ka ndodhur me Ukshin Hotin. Aq shumë jemi marrë me këtë, e edhe sot e kësaj dite, pas nëntë vitesh, akoma nuk e dimë të vërtetën. Nuk e dini as ju, nuk e di as unë. Vetëm ndonjë gjykim për Dubravën mund të na sjell gjer te e vërteta për atë se kush e ka nxjerrë Ukshin Hotin dhe se kah e ka dërguar pasi që e ka nxjerr nga burgu.

Vesna Tershelliq: Faleminderit, Behxhet Shala

Bexhet Shala: Ata që kanë bërë këtë, ata duhet të ekstradohen këtu, në vend ku e kanë kryer krimin, ngase nuk mund të dënohen në Serbi për krimet që kanë kryer në Kosovë, dhe nëse shkohet me këtë dinamikë si ka shkuar deri tani, edhe 1000 vjet nuk do të përfundojnë gjykimet për krime ndaj shqiptarëve në Kosovë. Pra, unë fuqishëm e mbroj qëndrimin që të gjithë ata që kanë kryer krime në Kosovë, të përgjigjen në Kosovë, ata që kanë kryer krime në Serbi në Serbi, ata të Kroacisë në Kroaci. Pra krimet duhet të kthehen në vendin e origjinës së krimit. Në asnjë mënyrë... Natasha përmendi Gjykatën e Hagës, ajo është krejt tjetër, Gjyqi i Hagës nuk krahasohet me këto gjykatat këtu, është një rast tjetër, ne shumë mirë e dimë Gjyqi i Hagës çfarë misioni ka... mirëpo fuqishëm e mbroj qëndrimin që ata duhet të gjykohen këtu, ngase në Serbi nuk ka disponim që opinioni të informohet për atë që ka ndodhë në Kosovë, mund të shihni se çfarë sëmundje intelektuale ka edhe 9 vjet pas përfundimit të luftës. Pra, qasja ndaj shqiptarëve është e pandryshuar, është edhe më radikale se sa ka qenë përpara. Unë nuk e di çfarë dëshmish

duhet të grumbullohen, ka aq shumë dëshmi, se ashtu thjeshtë, Dubrava flet vetë. Aty dihet mirë kush ka qenë përgjegjës, dihet mirë kush ka bërë krime, dihet mirë kush është dashur t'i mbrojë ata, të burgosurit duhet të kenë qenë të mbrojtur, aty nuk ka shumë për të zhvilluar hetime. Me pak fjalë, çka ka bërë Këshilli, Këshilli është në përpilim të listave të personave që janë vrarë, mirëpo ne i kemi listat deri në përfundim të luftës, ndërsa Fondi e vazhdon pas përfundimit të luftës, mbas qershorit. Tash jemi duke e bërë finalizimin e atyre listave, domethënë listat nuk janë complete, jemi gjithashtu duke bërë, ta quaj kushtimisht, gjeografinë e varrezave masive, e pastaj dëshmitë e atyre që kanë përjetuar ekzekutimet në masë, pra ne do të jemi gati kah fundi i vitit, ndoshta më së largu në tremujorin e vitit të ardhshëm të dalim me dy vëllime të monografisë për pasojat e luftës. Nuk pretendojmë t'i kemi grumbulluar të gjitha, por kemi problem me shumë të vrarë, dhe kemi problem të bëjmë një ndarje mes civilëve të vrarë e pastaj të ushtarëve e të policëve, ngase është shumë vështirë thjesht të bëhet një ndarje. Kah fundi i vitit pra, do ta bëjmë këtë. Kosova është një rast specifik. Kosova nuk mund të krahasohet as me Kroacinë, as me Serbinë, as me Bosnjën, ju e dini që Kosova e ka fituar njëfarë statusi, por prapë se prapë, Kosova ka disa pushtete. Institucionet e Kosovës, është UNMIK-u, është EULEX-i, pra nuk kemi një adresë ku të çohen dëshmitë, nuk kemi një adresë të saktë. Është një disponim që thjesht krimet e luftës të mbulohen për hir të një momenti politik, për hir të ruajtjes së qetësisë. Pra, për hir të ruajtjes së qetësisë në Kosovë këta janë në gjendje t'i sakrifikojnë të drejtat e njeriut, janë në gjendje t'i amnistojnë edhe kriminelët, edhe serbët edhe shqiptarët, të gjithë ata që i kanë kryer krime në Kosovë, tash për tash kanë imunitet. Më duket se për derisa është ky disponim si tani, tash për tash këta do të kenë imunitet, dhe është një iluzion se në Kosovë do të kemi sukses në dokumentimin e së vërtetës në një të ardhme të afërt. Ne mund të përpiqemi, ne do të bëjmë përpjekje, ne duhet t'i sigurojmë.... Mirëpo, nuk ka gatishmëri politike që ata që janë përgjegjës për krime në Kosovë të nxirren para gjyqit. Ju e dini shumë mirë që në Kosovë asnjë serb nuk është arrestuar, nuk është dënua për kryerje të veprave në Kosovë... Kryesisht këto hetime janë orientuar kah një karakter tjetër, pra janë arrestuar shqiptarët. Kjo nxit një dyshim... njerëzit nuk kanë dëshirë të angazhohen shumë. Partia e deritashme është dekurajuese, pra nuk ka gatishmëri që të arrestohen njerëzit e krimeve, dhe meqë nuk ka gatishmëri nuk ka as dëshmi të dëshmohet, meqë e dimë që ka rezerva të mëdha. Pra, po ju them që Kosova është rajon shumë pesimist, janë mbajtur konferenca, mund të formojmë komisione sa të doni, mirëpo do të ketë shumë probleme, por nëse nuk ka gatishmëri politike për luftimin e krimeve, atëherë është kot. Faleminderit.

Natasha Kandiç: Kështu Behxhet, unë të kam përkrahur shumë herë, shumë herë dhe ke pasur të drejtë, por kësaj radhe nuk ke të drejtë dhe nuk do të të përkrah. Ajo që vërtetë më brengos shumë, e mu kjo për arsye se sa herë që flitet për Kosovën, sa herë që flitet për Kosovën, atëherë gjithnjë ekziston njëfarë përshtypje se Kosova do që të mbetet tërësisht e izoluar. Unë mendoj se kjo nuk është mirë, unë mendoj se njerëzit nga Kosova, organizatat jo qeveritare nga Kosova duhet të kenë parasysh atë, se ky integrim rajonal është tejet i rëndësishëm. Duhet të jeni në dijeni se çfarë po ndodh me gjykimet në Bosnjë, çfarë po ndodh në Kroaci, çfarë po ndodh në Serbi, e jo që të përsëriten disa gjëra të cilat datojnë që nga koha e Millosheviqit. Pa marr parasysh se çfarë ka ndodhur në Serbi, në kuptimin politik situata është e tmerrshme. Të gjithë ne që po marrim sot pjesë këtu, konsiderojmë se Serbia po e udhëheq një politikë negative ndaj Kosovës, se kjo është në dëm të Kosovës, në dëm të të gjithë serbëve, se kjo është politikë e njëjtë e cila është udhëhequr edhe në Kroaci dhe Bosnjë, por kur kërkojmë dhe atje, publikisht, themi se duhet të ndërprehet me një politikë të tillë, se është në interesin e tërë rajonit që Serbia të përkrah Kosovën, Kosova edhe është e pavarur, dhe fjalët e Samarxhiqit, Koshtunicës dhe të

tjerëve nuk do ta bëjnë aspak më të pavarur, por kjo nuk do të thotë se gjykatat rijnë dhe i dëgjojnë ata zëra. Gjatë tërë kohës ne kemi gjykime të cilat janë shumë profesionale, gjykime... por nuk mund ti të më thuash mua se këto gjykime janë ashtu siç kanë qenë para lufte, e unë jam në gjykime, unë përfaqësoj viktimat nga Suhareka. Po ti nuk mund të ma thuash këtë. Unë jam tri javë në këto gjykime...prandaj Behxhet, eja ti në Beograd, eja ti përcjellësh ato gjykime, eja ti të shohësh një gjykatëse, Olivera Angjelkoviqin, e cila në valën e propagandës kundër Kosovës, kur e kanë përsëritur për nuk e di cilën herë: "Kosova është pjesë e Serbisë", kur ajo publikisht e ka mbajtur fjalën e saj me rastin e shqiptimit të vendimit Sinan Morinës, ku ka thënë se është turp, si gjykatës dhe si qenie njerëzore që prokuroria ka dalë me akuzë pa fakte, dhe publikisht ka thënë se ajo kërkon falje dhe e liron atë që është akuzuar i pafajshëm. Kjo është një gjë e madhe në këtë lloj gjykimesh për krimet e luftës. Ju lutem, ti ikim këtyre qasjeve negative. Qasja negative nuk do të na ndihmoj për asgjë. Ajo që ne na nevojitet është që të shohim se si do ti ndihmojnë njëri- tjetrit, si do t'ua lejmë gjeneratave të ardhshme, që atyre t'iu mundësohet të ndërtojnë raporte normale. Duam të jemi pozitiv, ashtu që komunikimi në mes njerëzve në rajon, ashtu që Kosova të jetë e integruar në territorin rajonal. Duam që të përkrahim çdo gjë që në Kosovë kontribuon në zhvillimin e një shteti stabil e demokratik. Nuk duam ton negativ. Natyrisht, të gjithë e dimë se nevojitet vullneti politik, por ne nuk jemi në partitë politike, ne nuk jemi bartës të qeverisë, ne i përkasim shoqërisë civile dhe përderisa ne qëndrojmë të gjithë së bashku, nga Bosnja, nga Kroacia, nga Mali i Zi, nga Kosova, nga Serbia, nga Sllovenia, nga Maqedonia, nëse qëndrojmë me idenë që të themelojmë Komisionin rajonal, nëse japim fuqi me nënshkrimin e "Një milion njerëzve", atëherë gjithsesi do të kemi ndikim në themelimin e këtij Komisioni dhe se kush do të jetë ai anëtarë, e atëherë është shansa jonë që të gjitha të dhënat, siç i ka Afrim Caka dhe siç i keni ju në kuvend, ne, dhe shumë të tjerë të paraqesim dhe të themi se duam përcaktimin e këtyre fakteve, duam pranimin publik të tyre, duam platformë publike që të mund të flasim për atë se çfarë ka ndodhur në Qabrat, Urën e Taliqit, se çfarë ka ndodhur në Vushtrri, se çfarë ka ndodhur kudo. Për këtë na nevojitet të jemi konstruktiv, pozitiv, të mos harrojmë se ne i përkasim shoqërisë civile.

Behxhet Shala: Unë fare nuk kam thënë se gjykatat në Serbi po punojnë si në kohën e Millosheviqit. Nuk e di se ku e ke dëgjuar dhe kush ta ka përcjell këtë. Unë kam thënë se Gjykatat në Serbi nuk e kanë ndërruar qëndrimin e serbeve ndaj shqiptarëve në Kosovë, këtë e kam thënë unë, e kjo dallon shumë në mes të kësaj që unë po e them dhe asaj që ti po thua. Unë kam qenë në gjykim në Beograd dhe nuk kam parë asnjë herë që nuk kanë gjykuar në mënyrë të drejtë. Kurrë nuk e kam thënë, e nuk po e them as tash. Këtë mos ma mvesh që unë e kam thënë. E dyta, në Kosovë, do të të përkrahin vetëm nëse mbledh të dhëna, le të themi, kundër Hashim Thaqit, kundër Daut Haradinajt, Ramush Haradinajt, Fatmir Limës dhe nëse duhet që ato të dhëna të shfrytëzohen si mjet kundër... Përndryshe këtu askush nuk do të të përkrah. Po them, ne kemi dorëzuar më se njëqind padi penale dhe asnjë nuk është zgjedhur, të gjithë këto i kanë lënë *ad acta* dhe askush nuk është marrë me to. Dhe më jepni një rast të vetëm që dikush nga serbët e Kosovës flet për shqiptarët e vrarë e ne mandej mund të bisedojmë. Po mendoj, unë nuk dua që ajo të jetë ashtu por hetimi po zhvillohet ekskluzivisht sipas linjës etnike, ekskluzivisht po zhvillohet kundër shqiptarëve, ja gjer tani, po them në Kosovë, nuk po flas për Hagën, unë gjithnjë kam thënë Haga është një institucion politik i cili kurrë nuk e ka ndarë drejtësinë. Për këtë unë po e them edhe tash, për këtë kam shumë argumente. Desha që të sqarohemi, mos ma mvesh atë se gjykatat janë si në kohën e Millosheviqit. Absolutisht këtë nuk e kam thënë, se kur them, unë e kam thënë publikisht, atëherë unë jam përgjegjës për atë që them, unë kam argumente. Kjo është e tëra, faleminderit.

Aleksandar Stojanoviq: Aleksandar Stojanoviq, Qendra për zhvillimin e shoqërisë civile. Vërtetë jam i befasuar me këto diskutime që nga fillimi. Mendoj se mjaft keq e udhëhiqni mbledhjen, se po lejoni të flasim për disa gjëra të cilat nuk janë tema direkte të kësaj bisede. Unë sot kam mundur të vij këtu me një mal dokumentacioni, mirëpo kam ardhur me vullnetin e mirë që të formohet rrjeti Rajonal dhe të përgjigjen të gjithë. Në tërë rajonin kushdo që ka kryer krim duhet të përgjigjet. Unë këtë po e them qartë, unë jam ai serbi nga Kosova që e thotë këtë. Mendoj se e keni thënë edhe këtë, se asnjë serb në Serbi nuk është gjykuar për krime të luftës në Kosovë. Por ju lutem, mendoj që kjo absolutisht nuk është e vërtetë dhe po flasim për disa gjëra të cilat... secila bashkësi duhet së pari të ketë qëndrim kritik ndaj vetvetes. Këtu kryesisht po flitet për atë bashkësinë tjetër me dozë mosbesimi e cila është, le të themi, deri diku tërësisht mund të arsyetohet dhe njerëzit të cilët kanë kryer krime lufte duhet të përgjigjen, mirëpo para së gjithash, çdokush duhet njëherë të pastroj oborrin e tij dhe ta kryej pjesën e vet. Pse është e nevojshme që të gjithë njerëzit të përgjigjen. Në shkurtin e kaluar, kjo ishte hera e dytë që në Kosovë paraqiten listat e serbëve, të gjallë dhe të vdekur të cilat hidhen nëpër fshatra, konkretisht në muajin shkurt në fshatin Prilluzhë, ku po ushtrohet presion ndaj popullatës së mbetur serbe që të shpërngulen, edhe pse në ato regjistra gjenden edhe disa emra të serbëve të vdekur, të cilët kanë vdekur para vitit 1999 dhe fare nuk kanë marrë pjesë në kurrfarë veprimtarish luftarake. Domethënë për shkak të të gjitha këtyre arsyeve ekziston nevoja që të përgjigjen të gjithë, që të sqarohet njëherë, siç ka thënë zonja Natasha, që ardhmërinë thjeshtë ta ndërtojmë në baza të shëndosha e jo që këtë barrë të së kaluarës t'ua lëmë në trashëgimi. Ajo që më intereson, e kam dashur të pyes është se përse sot, a u janë dërguar ftesat dhe përse nuk po marrin pjesë përfaqësuesit e të kidnepuarve dhe organizatave të ngjashme serbe nga rajoni gjithashtu, përse është kjo kështu, a ekzistojnë ato paragjykimet, mosmarrëveshjet me Natasha Kandiçin apo për çka është fjala. Mendoj se për shkak të legjitimitetit të të gjithë procesit dhe rajonit, absolutisht të gjithë duhet të marrin pjesë, ashtu që ky proces një ditë të ketë peshën e vlefshme historike dhe për këtë po më intereson ku janë përfaqësuesit, pse nuk duan të vijnë, të gjitha këto gjëra mendoj se duhet hapur në tavolinë dhe të shohim se për çka po flitet. Faleminderit.

Natasha Kandiç: Ja, do të përgjigjem menjëherë. Vetëm ju lutem, po ju lutem për një qëndrim pozitiv. Nëse vazhdojmë me një ton të tillë, e atëherë gjithnjë do të ketë diçka, kur ka diçka në Kosovë, kur është Kosova në pyetje, atëherë vie ajo, "asnjëherë nuk mund të ketë sukses si në Kroaci, Bosnjë, Mal të Zi", atëherë gjithnjë ekziston këtu ndonjë problem, ndonjë ton i cili është armiqësor. Le ti lëmë anash fajësimet. Për ne është e nevojshme që të përcaktojmë faktet dhe të udhëhiqemi me atë se si ti ndihmojmë të gjithë. Më 8 maj, 2008, ne kemi mbajtur konsultime, në Podgoricë, me përfaqësuesit e shoqatave të viktimave nga rajoni. Ka qenë njësoj, një sallë e madhe me jashtëzakonisht shumë pjesëmarrës, ka qenë rrëmujë sepse, ashtu si edhe sot, kanë ardhur më tepër njerëz se që kanë qenë të ftuar. Kanë qenë edhe serbet nga familjet e të zhdukurve dhe të kidnepuarve, dhe e kanë përkrahur shumë këtë iniciativë, kanë qenë shumë konstruktiv, bile edhe Sima Spasiq, për shkak të të cilit kemi shtyer disa herë disa gjëra, por edhe ai ka qenë shumë konstruktiv. Lidhur me takimin e sotëm, me konsultimet e sotme, çka ndodhi? Ju e dini se mbledhja e ICMP në Ohër, e cila është dashur të mbahet sot dhe nesër, është shtyrë. Lidhur me këtë takim, është bërë presion në ta, edhe atë, është bërë presion në atë pjesën më të fortë, më ekstreme të Qeverisë së Serbisë, e kjo është ministri Samargjiq, e disa të tillëve, Koshtunicës, të cilët tërësisht po zbresin nga skena politike, e nuk po e bëj përjashtim as këtë, si quhen këta nga Mitrovica, ata Jakshiqët...që kanë bërë presion në ta dhe nga frika nuk kanë ardhur, e pjesërisht edhe për shkak se ky tubim po mbahet këtu, në pjesën jugore të Mitrovicës.

Përndryshe, ata kishin ardhur ashtu siç kanë ardhur në Podgoricë, kishin ardhur po të mos ishte ai presioni i tmerrshëm politik në ta dhe ata të shkretët janë plotësisht të humbur. Nuk dinë çfarë të bëjnë kur ai Samargjiq-i u thotë diçka, e ata në të vërtetë nuk dinë se çfarë të bëjnë në këtë situatë. Kështu që unë i arsyetoj dhe i kuptoj plotësisht sepse ata të shkretët janë plotësisht të humbur, e në Podgoricë kanë qenë, ja unë nuk e di se sa njerëz kanë qenë në Podgoricë, ata jo vetëm që kanë marrë pjesë por edhe kanë qenë shumë konstruktiv, kanë përkrahur dhe janë mburrur me atë se si ata kanë komunikim të shkëlqyer me të gjitha shoqatat në Kosovë. Ju lutem, për hir të të vërtetës, për hir të fakteve, pasi që aq shumë po insistojmë në fakte, asnjë serb në Serbi nuk është dënuar plotfuqishëm për krimet në Kosovë. Tash po gjykohet për krimet në Suharekë/, gjykimi ende nuk ka përfunduar. Po gjykohen dy policë për vrasjen e vëllezërve Bytyqi, as ai gjykim nuk ka përfunduar. Ajo që ka përfunduar në Serbi, është dënimi në trembëdhjetë vite i shqiptarit, Anton Lekaj; me vendim të plotfuqishëm është liruar Sinan Morina, e tash po përgatiten hetimet për vrasjet në Pusto Selo, ne e kemi hapur procedurën..., po, po, për Podujevën, qe harrova, është dënuar Sasha Cvijetan me dënimin më të lartë për vrasje të grave dhe fëmijëve në Podujevë, tash është procedurë e re kundër katër personave për atë vrasjen e njëjtë. Po ju lutem ti lëjmë ato fjalë se kush për çka. Është e rëndësishme se gjithkund mbahen gjykimet dhe që janë në procedurë e sipër, por gjykimet nuk do të mjaftojnë, të provojmë në mënyrë pozitive të gjejmë se si mundemi që të gjithë të ndihmojmë. Unë e përkrah shumë dhe jam e lumtur që e thatë, se secili që ka bërë krim duhet të përgjigjet, po për fat të keq kjo nuk do të ndodh për shkak se nuk ka asi gjykata, nuk ka kapacitete të atyre gjykatave të cilat mund ta bëjnë këtë, por ejani që ne të tentojmë me disa instrumente të tjera. Për disa vepra tjera penale nuk do të jenë të nevojshme as gjykimet, as nuk e di se çka. Mendoni se ndonjë gjykatë do të gjykojë për shkatërrimin e pronës? Nuk ka asi kapaciteti, kjo nuk do të ndodh. Po ejani të shohim... shikoni, familjet e viktimave janë... një numër i madh i tyre sot janë familje të shkatërruara. Në shoqëritë normale të gjithë ata marrin reparacione, dëmshpërblime në të holla, ejani e të shohim ne si do të mundeshim t'i detyrojmë ato qeveri apo Serbinë dhe shtete e tjera që të formohet një fond, e pastaj të formohen kriteret se si do të bëhet ajo shpërndarje, kush do të trajtohet si viktimë të marrin disa dëmshpërblime në të holla të cilat do t'iu tregojnë se shoqëria, shtetet, qeveritë, e pranojnë atë padrejtësi e cila iu është bërë në jetë.

Vesna Tershelliq: Radhën e ka Lushi dhe mendoj se kjo do të jetë i fundit para pauzës. Në orën 16:00 e kemi pauzën

Lush Krasniqi: Unë kërkoj falje nga të pranishmit, sepse gjithë nga ne kemi për të thënë shumë, fatkeqësisht, disa nga ne kemi përjetime dhe histori të dhimbshme, të cilat janë të vështira të paraqiten e të shprehen. Unë si fillim desha të them duhet të ndahet në dy antagonizma, e vërteta dhe sekreti, e drejta dhe e padrejta, krimineli edhe viktimja, e kështu pa fund çdo gjë shkon në dyshe. Qëllimi i kësaj mbledhjeje të sotme, dhe organizatorëve të këtyre tri organizatave, dokumentit për ballafaqim të së kaluarës, Fondi për të Drejtën Humanitare, dhe Qendra Hulumtuese e Kërkimore, tash afër tri vite shihet që së bashku me një përkrahje sado të vogël, po mundohen të arrijnë tek e vërteta, si një terapi e vetme që në njëfarë mase do të arrinte që viktimat t'i rehabilitonte. Është cekur disa herë në kësi lloj takimesh, se nuk janë viktimja vetëm ata që kanë vdekur, por jemi viktimja edhe ne, me një dimension shumë më të lartë të pasojave, pra është vështirë të përmenden. Unë pajtohem se ky Komision sipas mendimit tim, nuk është dhënë emërtimi, Komision rajonal i së drejtës apo së vërtetës, kjo me siguri në fund do të emërtohet, por si kuptim Komision Rajonal, pra kur lexojmë këtë emërtim, nënkuptojmë se ky duhet të shtrihet jashtë kufijve shtetërorë, sepse me një bllokadë të tillë të shteteve që kanë qenë në luftë të armatosur nuk mund të arrihet tek e vërteta. Vetëm thyerja e këtij muri ose këtij kufiri

dhe përfshirja rajonale e të gjithë atyre që luftojnë për të vërtetën dhe të drejtën mund të arrihet sado pak një sukses, sepse të gjithë mendojnë që sukcesi pa dënimin e gjithë atyre që kanë kryer këto krime nuk mund të realizohet asnjëherë. Sidoqoftë, mund të ketë rezultate gjysmake, por të vërtetë gjysmake nuk do të ketë kurrë. E vërteta duhet të jetë deri në fund, ose fare. U cek disa herë edhe vendi i gjykit për autorët e krimit. Për mua, unë personalisht ndaj opinionin që nuk është me rëndësi, me rëndësi është që gjykim të ketë, dhe me rëndësi është që gjykata të jetë gjykatë në kuptimin e plotë të fjalës, pasi që për një punë të tillë, një profesion të tillë, jepet edhe betimi. Sa i përket vendit të gjykit, për krimet për shembull në Kosovë, sidomos komuniteti ndërkombëtar dhe populli i Kosovës që din shumë për autorët e krimeve, për atë çka ka ndodhë sepse Kosova është e vogël, por fatkeqësisht, opinionin në Serbi, populli i cili kurrë s'mund të jetë në përgjithësi fajtor, jo vetëm ai por asnjë popull nuk mund të fajësohet, populli serb shumë pak di për krimet që janë bërë në shtetet tjera të ish-Jugosllavisë. Edhe vetë kam qenë pjesëmarrës dhe jam në gjendje ta them të vërtetën, aty ku duhet dhe aty ku kërkohet, duke mos pasur frikë nga askush, derisa nuk ndihem i frikësuar dhe nuk ndihem fajtor për asgjë. Andaj, për të thyer atë bllokadë propaganduese dhe dezinformuese që ekziston në Serbi, ne duhet që të publikisht të shprehim dëshmitë tona, e pse jo edhe në mesin ku jetojnë kriminelët serbë, të shkojmë e së paku t'i trazojmë dhe t'u themi që nuk jemi të harruar. Kjo vlen jo vetëm për Serbi por për të gjitha ato vende ku kriminelët fatkeqësisht bëjnë një jetë shumë luksoze. Kujtoj që popullit duhet t'i thuhet e vërteta, dhe kriminelët e kryerësit e krimeve të nxirren para drejtësisë. Flas për ata të gjithë që kanë kryer krime, në ish-Jugosllavi e kudo në botë. Nuk flasim për njerëz të vetëm, edhe pse nganjëherë po tentojmë t'i përvetësojmë gjërat. Krimineli është kriminel kudo qoftë, viktimat është viktima, dhe duhet të trajtohen njësoj. Ky Komision Rajonal i së vërtetës do të ketë pengesa, sepse më mirë i di këto organizata që kanë pengesa, e s'mund të arrijnë synimin sa më shpejt, sepse gjithmonë dihet që e vërteta është vështirë të nxirret edhe brenda familjeve tona. Kemi sekrete që nuk mund t'i zbulojmë edhe pse kemi raporte familjare. Besoj që në këtë entuziazëm që ka dhe me përkrahjen, fatmirësisht, të individëve, organizatave, viktimave, bile kohën e fundit edhe disa pjesëmarrësve direktë në luftëra, besoj se do t'ia arrijmë. Unë vetëm do të inkurajoja këtë, se do të arrijmë, dhe kudo qoftë një gjykim i saktë, një gjykim i paanshëm, dhe një e vërtetë, do të ishte shumë ngushëlluese për viktimat që kanë përjetuar gjëra të papërshkrueshme në këto treva të shteteve të ish-Jugosllavisë. Kaq, ju faleminderit.

Vesna Tershelliq: Shumë faleminderit Lush. Kemi edhe dy folës pas pauze. Pauza është gjer në 16:30 dhe gjatë kohës së pauzës do të bëhet edhe refundacioni i shpenzimeve.

Pauza

Vesna Tershelliq: Ja këtu e keni mikrofonin, vetëm le të përfundojnë njerëzit fjalimet. Udhëroni.

Xhemajli Thaçi: Pra, ju në radhë të parë po kërkon bashkëpunim me Fondin për Iniciativa të Reja, mirëpo si të bëhet ai bashkëpunim, kur dihet që, të themi ashtu, rasti i grupit të Gjakovës është ende në shqyrtim. Do të thotë që megjithatë nuk jemi marrë aspak me këtë lëndë, çka do të thotë për regjimin momental në Serbi që lëndën e ka kthyer edhe një herë në rishqyrtim. Jam i interesuar të di për disa gjëra, do të shkoj mjaft shkurt këtu. Në radhë të parë dua të di, thjesht, me të zhdukurit ku qëndron puna, pse nuk shkojnë gjërat më tutje, kur dihet që x kufoma janë identifikuar dhe nuk po kthehen, pse nuk kthehen ato?

Mandej më intereson të di pse shumë pak, apo aspak, nuk jeni marrë me rastin e Dubravës, meqenëse edhe jam përjetues i asaj masakre, dhe është njëra prej masakrave që është kryer në mënyrë institucionale, do të thotë prej ditës së parë e deri të fundit. Mendoj që ka fakte mjaft, siç e tha edhe parafolësi, Z. Caka, mandej unë mendoj që ju mund të vini deri tek të dhënat shumë

më lehtë sesa në ndonjë rast tjetër, kur është fjala në Kosovë. Si është e mundur që ju mos të demaskoni një rast shumë interesant, rastin e gjykimit të grupit të Gjakovës në Nish, ku në atë rast dënohen edhe të vdekurit? Pse nuk e keni demaskuar në opinionin tuaj serb këtë rast, dhe pse nuk merreni nga fillimi një nga një me secilin rast, por këtu për rastin në Kosovë, disi shkoni në mënyrë sipërfaqësore, dhe për secilin rast pak nga pak, e jo t'i hyhet një rasti e të shkohet deri në fund. Unë mendoj që rasti i Dubravës është rasti më i lehtë, sepse është kryer në mënyrë institucionale kjo masakër. Kështu unë mendoj që këtu mund ta dëshmoni, mund ta vërtetoni atë simpati nga shqiptarët.

Natasha Kandiç: Hajde ta ndërrojmë tonin. Prej nga jeni ju?

Xhemajli Thaçi: Jam Xhemajli Thaçi nga Gjakova.

Natasha Kandiç: Nga Gjakova. Pasi jeni nga Gjakova atëherë nuk do të duhej fare të flisni ashtu. Mendoj se askush në Gjakovë nuk ka të drejtë të flet ashtu si po flisni ju. Ju keni qenë në burg atëherë kur unë kam ardhur në Gjakovë/, kur njerëzit kanë dalur nëpër rrugë dhe kur kemi penguar policinë që të bëj masakër. Dhe ju lutem, unë nuk dua që të ndjem theks se dikush po më akuzon, ju gjatë tërë kohës po akuzoni, ashtu po flisni.

Ndërhyrje

Natasha Kandiç: Ju lutem, unë fare nuk do të lejoj të më thotë ashtu diçka. E posaçërisht nuk do të lejoj që ashtu të flet ndokush nga Gjakova. Ju keni mundur, kur jeni kthyer nga burgu të pyesni se çka ka ndodhur në Gjakovë, e jo të vini këtu sot, e të flisni në këtë mënyrë, të thoni ju keni mundur këtë, ju po i bëni nderë këtij regjimi të sotëm. Nuk duam kurrfarë toni politik këtu, duam... ju keni shkuar në burg, nuk keni pësuar ashtu siç kanë pësuar shumë në Gjakovë, por keni qenë në burg, e kujtohuni mirë kur unë kam ardhur në burg, kur ka qenë kryengritja, e kujtohuni mirë për pakot e organizuara, e kujtojini gjykimet dhe mbrojtjen të cilën e keni patur ju, e të cilën e kemi bërë ne. Kështu që, ju lutem, unë nuk do të lejoj që ju, mu për atë që jeni nga Gjakova të flisni në atë mënyrë, prandaj uluni dhe pyesni ata të cilët kanë ndenjur nëpër bodrume në Gjakovë se çka ka ndodhur atje në ditën e fundit para se të hynte KFOR-i. E dyta, ju lutem, kemi thënë se ekziston Dubrava, ekzistojnë shumë e shumë raste, dhe tash... unë e di gjer në detaje se çka ka ndodhur në Dubravë, por e di gjer në detaje edhe atë se çka ka ndodhur edhe në vendet tjera gjatë kohës së bombardimeve të NATO-s, para bombardimit të NATO-s, pas bombardimit të NATO-s. Lejoni që të organizohemi dhe të mendojmë se si ti nxjerrim të gjitha ato fakte, si ti përcaktojmë, e jo tash përsëri të kthehemi te Dubrava. Çka sikur të ndodheshin këtu 10 njerëz nga Meja, nga Korenica, sikur të kishte nga Smrekovnica, të kishte nga Podujeva, të kishte nga Peja, sikur të kishte nga Istogu... e sikur... po ejani e të mendojmë për mënyrën se si ti vërtetojmë. Ju lutem, nuk ekziston asnjë regjim të cilit unë do të bëja ndere. Kjo është vetëm për viktimat dhe po ju lutem që edhe ju të mendoni për viktimat, por për të gjitha viktimat. Dhe të mendoni në atë mënyrë që do të thoni '' nëse të gjitha këto organizata, nga Kroacia, nga Bosnja dhe Hercegovina, nga Mali i Zi, nëse të gjithat po e përkrahin themelimin e Komisionit Rajonal, të shohim se ne çka mund të bëjmë ne prej Kosovës''. Ejani e shikojeni pak këtë kontekst rajonal, nivel rajonal, çka fitojmë me këtë. Si, për shembull, ta dinë të gjithë se çka ka ndodhur në Dubravë? Nëse ekzistojnë të gjitha të dhënat, nëse ju thoni se është rast i lehtë, atëherë ejani dhe ta përgatisim atë raport i cili ka me qenë i mjaftueshëm për çdo gjykatë. Në Strazburg nuk mundemi, në Strazburg mund të shkohet kur ndonjë proces ka përfunduar në gjykatat nacionale, para kësaj nuk mund të shkohet në Gjykatën Evropiane për të drejtat e njeriut. Dhe ju lutem, mos të vazhdojmë më me akuzat, po ejani e të vazhdojmë me propozimet, me iniciativat që të kuptojnë të gjithë se çfarë ka ndodhur.

Vesna Tershelliq: Folësi i ardhshëm është Mirko Kovaçiq nga Vukovari. Zotëri Mirko, a mund të vini këtu që të ju dëgjojmë më mirë.

Mirko Kovaçiq: Më duhet të prezantohem edhe një herë, jam Mirko Kovaçiq nga Vukovari, anëtarë i shoqatës *Nënat e Vukovarit* dhe i Këshillit ekzekutiv të Lidhjes të të vrarëve dhe të zhdukurve, përndryshe, ta plotësoj këtë biografi të pikëlluar, unë edhe jam llogorash i llogoreve serbe, dhe kam mbetur pa disa pjesë të trupit. Dua t'ua afroj, të më dëgjoni, që kjo konferencë, ky takim, të ndihmojmë të arrijmë gjer te e vërteta. Do t'ia filloj me storjen time... ju e dini *Ovqarin*, Vukovar, 250 të plagosur janë marrë, të vrarë pa gjykime. Ju e dini për fshatin Lovas, prej nga jam unë, ku 80 fshatarë janë dërguar në fushat e minuara, kanë vdekur 42 nga ata. Të gjitha ato gjykime janë mbajtur në Beograd. Gjykimi *Ovqare* ka filluar para katër viteve, dhe nuk ka përfunduar ende nga arsyeja të cilën dua ta potencoj sot këtu, se politika ka ende ndikim të madh në gjykata dhe marrëveshjet në gjykata. Nuk ka përfunduar për atë arsye, shpresojmë se pas këtyre ndryshimeve, do të vijë deri te përfundimtarja, sepse vendimi i parë është anuluar dhe Gjykata Supreme e Serbisë e ka rikthyer në gjykim. Gjykimi i parë, unë si llogorash, përndryshe në Beograd kam punuar para lufte, një vit pas shkollës, pas llogorit kam menduar se kurrë më nuk do të shkeli në Beograd. Mirëpo unë kam përcjellur gjykimet prej të parit gjer te tjetri. Me mua ka qenë edhe ambasadori i Kroacisë, ka qenë përfaqësues, dy avokatë të Gjykatës së Hagës të cilët kanë mbrojtur të dënuarit tanë në Hagë, kanë qenë prezent në tri gjykime dhe ata, avokatë të spikatur, kanë thënë si vijon: "Ne nuk kemi çfarë të kërkojmë këtu, kjo gjykatë është gjykatë më korrekte se Gjykata e Hagës" në krye me kryetarin, atëherë Kryesinë e Gjykatës e ka udhëhequr gjykatësi Krstajiç. Gjykimi ka mbaruar në mënyrë shumë korrekte. Gjykimi i dytë *Ovqare* ka filluar, Lovasa gjithashtu po vijon, se të gjithë kriminelët prezent, akterët, prezent në Serbi, përndryshe janë qytetar të Republikës së Kroacisë. Kjo aspak nuk po na pengon, dhe ne me të dyja duart dhe këmbët kemi pranuar qëndrimet e gjykatave në Beograd të cilat janë plotësisht të pavarura. E tash ta them të kundërtën, gjykimet e dy gjeneralëve tanë në Kroaci dhe gjykimet e disa kriminelëve, kurrë nuk kanë përfunduar. Pse? Se politika e ka ndikimin e vet, se Pera në fjalë e ka kushëri të akuzuarin Stevën dhe atëherë gjithnjë gjendet arsyetimi që të shmanget, që të eskivohet. Këto gjykime që po zgjasin, në Glavash dhe Osijek, dihet se kanë qenë krime numër një dhe se serbet kanë qenë të vrarë me dorën e tij, respektivisht me urdhrin e tij. Kjo po eskivohet edhe sot e kësaj dite, ai gjyq është komedi. Ja se çka mund të ndodh në gjykatë, kjo edhe ka ndodh në Beograd dhe ka ndodh që dy të akuzuar të pështyjnë në njëri-tjetrin edhe të sulmojnë. Kjo është e pakuptueshme. Respekti maksimal i të akuzuarit është vërtetuar, ai është deklaruar rreth fajit apo pafajësisë së tij, mbrohet në mënyrë korrekte çka edhe gjykata e pranon. Ne, vështuesit e vlerësojmë këtë dhe jemi tërësisht neutral. Unë nuk dua t'iu mërzis më tepër, kolegë të dashur nga Kosova, është hera e tretë që jam në Kosovë, kam punuar në Pejë, e kam punuar fabrikën tuaj të këpucëve, e në Prishtinë, për herë të parë kam qenë në vitin 1957, kur si i ri kam marrë pjesë në ndërtimin e hekurudhës Durrës- Elbasan, si shpërblim pata fituar udhëtimin nëpër Prishtinë, kur kam qenë fëmijë 15 vjeçar. Prandaj, po ju lutem, bisedoni tash, është nxehtë, pranojeni këtë iniciativën tonë dhe të fillojmë punën por akuzën duhet ta përpiloni në mënyrë mikroskopike, mos e anashkaloni as edhe një presje në akuzë. Përse treshja jonë është dënuar aq lehtë në Hagë, Shlivqanin e të tjerët. A e dini përse? Sepse ne e përpiluan në shpejtësi një akuzë, dhe në mesin e të vrarëve në *Ovqare* kemi futur dy persona që janë të gjallë dhe të cilët po jetojnë në Kanadë, edhe normal, kur Gjykata e Hagës e ka kuptuar këtë, pa kurrfarë diskutimi, nuk vleu edhe mbaroi. Ju jeni të lirë, rrini në shtëpi dhe kjo është ajo. Prandaj më mirë kolegët e mi, brengosuni si të gjeni emrat dhe mbiemrat e dëshmitarëve, kush

dhe çka ka bërë. Ju e keni mbijetuar tërë atë dhe ashtu duhet të veproni. Dhe atë akuzë ta lansoni. Faleminderit dhe rrofshi.

Vesna Tershelliq: Faleminderit. Urdhëroni.

Milot Berisha: Jam nga Nisma e të Rinjve për të Drejta të Njeriut, mendoj që kjo iniciativë është shumë e mirë, mendoj që është shumë e rëndësishme që të kemi një të vërtetë, bile për të ardhmen, siç tha edhe zonja Natasha, bile fëmijët tanë apo gjeneratat e ardhshme të dinë se çfarë ka ndodh. Unë personalisht nuk jam në gjendje t'i shpjegoj dikujt se çka ka ndodhë, ndoshta pse kam qenë në Prishtinë dhe nuk kam qenë në vende ku kanë ndodhë ato gjëra. Veçse i kam dy pyetje për Komisionin, njëra është që është me rëndësi më së pari, personalisht mendoj, që të dihet e vërteta, pa marrë parasysh a gjykojnë ata që e kanë shkaktuar atë apo jo, kisha pasë qejf me përmend amnistinë, mendoj që ndoshta për të nxjerrë diçka ndoshta amnistia do të ishte e nevojshme, se është më mirë me pas të vërtetën sesa me pas gjykimin. E dyta, kisha dëshiruar që ky Komisioni të ketë jetëgjatësi sa më të shkurtër, në kuptimin që ta kryejë mandatin e vet sa më shpejt, sa më shpejt të vijë tek e vërteta, dhe gjitha ato që duhet të dalin nga ky Komision. Faleminderit.

Lazar Ampovski: Të prezantohem edhe njëherë, unë jam Lazar Ampovski, nga Qendra për zhvillimin e shoqërisë civile nga veriu i Mitrovicës. Natasha Kandiç mirë e tha që duhet të pushojmë me akuzat dhe të shikojmë se çfarë mund të bëjmë. Sa i përket akuzave tuaja, është e vërtetë, ka ndodhur çfarë ka ndodhur, askush nuk po e mohon këtë, nuk është hera e parë, ju lutem, nuk është hera e parë. Unë mund t'iu jap akuzat që pas qershorit të vitit 1999, mund t'iu sjellë një grumbull të tërë të tyre, nëse ne fillojmë të numërojmë viktimat, unë mundem, ne mundemi t'i numërojmë një muaj të tërë, dhe në fund të mos bëjmë asgjë. Ajo që unë propozoj, është që thjeshtë, kur Komisioni t'ia filloj punës së vet, do me thënë ky është propozimi im, që të shkohet në të gjitha ato organizatat, të cilat janë të lidhura apo punojnë drejtë për së drejti me viktimat apo edhe vetë kanë qenë viktimat në ndonjë mënyrë apo tjetër, që të mblidhen, të mblidhen të gjithë emrat e mbiemrat e të vrarëve, të zhdukurve, të dhunuarve, si do që të jetë, pa marrë parasysh se a janë ata kroatë, a janë myslimanë nga Bosnja, a janë shqiptarë, a janë serb. Domethënë plotësisht, plotësisht duhet të bëhet një punë fer dhe korrekte. Për të arritur gjer aty, ne thjeshtë duhet të pushojmë me këto akuza se përndryshe asgjë nuk do të arrijmë sot. Natyrisht, se do të dënohen por së pari duhet të shohim se çka është bërë krejt. Unë po mendoj se ky takim nuk është thirrur për të numëruar viktimat, aq sa kam kuptuar unë. Juve ju tha Natasha Kandiçi se në muajin tetor do të organizohet, se aty do të mund ti paraqitni ato. Unë mendoj se nuk është as koha e as vendi, dhe se nuk jemi takuar për këtë. Pajtohem se secili kriminel veçanërisht duhet të dal para drejtësisë. Unë, gjithashtu dua t'a përshëndes zotëriun, ju keni fituar, ju keni kërkuar që gjykimi të mbahet këtu, këtu në Kosovë, para gjykatës shqiptare por unë mendoj se këtu gjykata juaj, ta quaj ashtu, nuk është ende e legjitimuar ndërkombëtarisht dhe njeriu ju ka dhënë dëshmi se gjykimet e serbëve në Serbi janë shumë më korrekte se gjykimet e serbëve në Kroaci.

Vesna Tershelliq: Ju lutem dëgjoni, e juve, ju lutem që t'i drejtoheni të gjithëve, e jo vetëm zotërinjëve përballë jush.

Lazar Ampovski: Jo, unë atë e morra vetëm si shembull, asgjë më tepër.

Vesna Tershelliq: Vetëm po ju lutem që t'i drejtoheni të gjithëve, e jo të bëni bisedë mes dy personave. Por mos ndërhyini në fjalë, të dëgjojmë gjer në fund.

Ramadan Ilazi: Unë jam Ramadan Ilazi, vij nga Ferizaj-Uroševac kam pi kafe me disa miq të mi dhe rastësisht kam dëgjua se në qytetin tim dmth në Ferizaj janë 11 serbë që janë të zhdukur edhe këta 11 serbë që janë të zhdukur, janë zhdukur në vitin 1999, kurse unë kam dëgjua në vitin 2008 edhe jam tmerrua për këtë informatë, unë kam mendua që në Ferizaj nuk kanë ndodh gjëra

të tilla absolutisht jam tmerrua dhe sa herë e shoh tregimin për familjet në Mehe gjithë ata fëmijë, ato nëna pa të afërmit e tyre dhe u tmerrova nga fotografitë që i tregoi zoti Caka, megjithatë unë këtu mendoj që këtu sot në kapacitetin e atyre njerëzve që mendojnë në zgjidhjen e problemit ne duhet të ofrojmë kontributin tonë jo në aspektin politik as emocional por në aspektin tërësisht teknik profesional edhe këtë e kemi edhe obligim. Komisioni për zbardhjen e krimeve që kanë ndodh në ish Jugosllavi është një ide fenomenale dhe unë mendoj që duhet të funksionalizohet dhe duhet të mbështetet, çka unë mendoj që rrezikon ky komision shumë është aspekti politik do të thotë e deri tash procesi në Kosovë ndarja, mos funksionaliteti gjithmonë viktimat e luftës, të rënit në luftë janë përdorur për qëllime për qëllime politike dhe ky komision do të bëjë çmos që ta parandaloj këtë që të filloj të trajtohet çështja e krimeve në ish Jugosllavi si të çështje e të drejtave të njeriut dhe asnjëherë në atë aspekt politik, prandaj kjo është një detyrë që unë mendoj që komisioni duhet ta ketë parasysh, e dyta duhet të reklamohet më shumë puna e komisionit, duhet të reklamohet ma shumë mundësitë që kanë viktimat për t'i adresuar çështjet e tyre në organet përkatëse. Edhe e gjithë kjo, unë jam sot shumë shumë mirënjohës që kam qenë në këtë mes, që kam pas mundësi me dëgjua disa tregime, por unë mendoj që të gjithë ne këtu e kemi një obligim më së pari si qytetarë për me bo diçka dhe në lagjen tonë ku jetojmë me i njoftua të tjerët se në Kosovë nuk janë viktima vetëm shqiptarët por ka edhe viktima tjera edhe që viktimat nuk kanë identitet etnik në atë aspekt por janë viktima dhe krimet nuk mund të trajtohen në bazë të identitetit etnik as politik ato janë krime, edhe një është kjo ajo detyra e komisionit që ta vendos krimin si krim dhe jo krim në atë aspekt nëse je shqiptarë apo nëse je serbë, faleminderit.

Vesna Tershelliq: Faleminderit. Pas jush.

Ferdane Osmani: Është Diçka tjetër, folja midis neve është diçka tjetër, në qoftë se dalim me gjyku atëherë iniciativa është shumë e mirë se duhemi me i përgatitë faktet, në çdo gjykatë a është në Kosovë, a është në Serbi, a është në Kroaci në qoftë se nuk i keni faktet nuk mundeni me fitu pa marrë parasysh në qoftë se keni të drejtë, i keni emrat, përgatitni emrat për tetor për të gjithë që keni dëshmitar, zotëria në atë anë, të dytë po thonë se kanë të zhdukur, keni, kemi na keni ju, lufta ka qenë edhe ju përgatitni faktet për tetor, por ne këtu kemi ardh për me pa iniciativën se a do të hyjmë në komision regjional, duheni me e kuptu në qoftë se komplet ish Jugosllavia në trojet në të cilat kanë ndodhë gjërat që janë tepër negative ne duhet me bashkëpunua, në qoftë se nuk i kemi kuptua çka do me thënë që kjo i kemi, që i kemi zyrtar e fondit humanitar në të cilat me bisedu më gjerësisht, na në qoftë se e duam këtë iniciativë duhemi që krejt organizatat pa marrë parasysh cilit nacionalitet me bashkëpunua për me e ditë realitetin, që bëhet gjykimi në Beograd, bëhet shkaku që nuk ekziston gjykimi, gjykata speciale për krime në Kosovë edhe vetë jam kon prezent dhe mundem me tregu që është e drejtë, kam shkua privatisht për me vërtetu, për shkak të asaj ju them s'ka, në qoftë se e doni të vërtetën pa edhe në qoftë se duhet edhe në Rusi e vërteta duhet me dal, në qoftë se i keni fakte përgatitni faktet, i keni emrat lypni dëshmitarë, dëshmitarë okular, jo ky ka thonë, unë e pash këto ai e ka pa ato, merrni dëgjomëni na duhet iniciativë se qeveria nuk punojnë kurrëgjë, faktet i dimë, 9 vite, ju lutem edhe në Hagë i keni fotografitë, e dëshmitar, i cili i rrëzon fotografitë ju duheni, nuk kemi polemikë, na jemi këtu për iniciativë, viktima është viktimë, viktimë jam edhe unë, edhe unë kam trauma edhe fëmijët e mi kanë traumë, besomëni për mu viktimat më të mëdha janë ata njerëz në Kosovë, në Bosnjë që kanë qëndruar si civil nëpër shtëpia të veta nëpër podume, besomëni, na nuk jemi gjykatës, veç po ju tregoj që iniciativa ime për mua është që organizatat, të cilat merren për daljen në të vërtetë, duhet me u organizua, ju keni problem me të dhënat në Kosovë, keni probleme në gjykata nuk kanë data baza, i keni prokuroritë nuk kanë

data baza duhet me shkua nëpër shpija, i keni organizatat, të cilat merren me të zhdukur, por a kanë komplet a s'kanë komplet të dhënat varet çka kërkojnë ata varet çka kërkojnë të tjerët, në qoftë se duhet iniciativa, dëshira ime për mu bashku edhe Kosova në këtë Komision, Kosova si Kosovë ka përparësi shkaku që Kroacia e Bosnja i kanë përvoja më të gjata dhe duhet me bashkëpunua për me i ditë mangësitë që ata janë përballur për me kalua ne sende më pozitive edhe me e luftua sa më mirë, në qoftë se krejt bashkohemi me këtë komision do ti kemi edhe faktet më të forta, nuk është marre edhe nuk është as ultësi me e vet edhe kundërshtarin më të madh, se vetëm kur bashkëpunohet edhe dalin fakte mundemi me krijua diçka, me tejkalua politikën, besomëni se krejt na po flasim kështu, a në jetë private krejt jemi duke bashkëpunua me njëri tjetrin jemi miq e flasim, ashtu duhet edhe në tavolinë kur duhet me luftu për të vërtetën, për mu është shumë me rëndësi që për shembull ju e keni në Kosovë, i kemi vendet ku janë , për mu angazhu më shumë iniciativa nuk ka informata as prej Fondit, çka është duke vepru, cili është cili, neve na keni thirr na i dimë punët e juve se i përcjellim vetë si organizata, por kemi shumë persona që nuk janë të vetëdijshtëm transparenca më të madhe, mandej është mungesa e mediave, informimi i mediave, puna juaj për këtë ide për komisionin regional civil. Në qoftë se punojmë më shumë në marketing po më duket se do të ketë më shumë sukses. Në Pejë, fillimisht dmth unë fillimisht do t'i parashtroja vetes një pyetje se çfarë kam bërë unë deri më tani në lidhje me këtë çështje, unë nuk i drejtohem asnjëherë se çfarë ka bërë Natasha ose çfarë ka bërë Naseri, po hajde të shohim se çfarë mund të bëjmë gjithë së bashku, na po mundohemi me e kriju një komision, që ka mungu deri më tani, është një iniciativë jashtëzakonisht e mirë se e kemi parë që janë mbledh shumë fakte, na përveç që jemi të zhgënjyer, u tha këtu që shqiptarët nuk pajtohen që të shkojnë të dëshmojnë në gjykatat e Serbisë pasi që janë të manipulume, kurse serbët thonë që gjykatat e Kosovës domethënë nuk njihen ndërkombëtarisht dhe thjeshtë nuk u besojnë, dmth i kemi dy tabore domethënë i kemi dy, ma tepër i marri si paragjykime, ne çfarë do të bëjmë ne si komision, t'i marrim t'i shqyrtojmë ato raste të cilat janë gjykuar deri më tani dhe të shohim se ku është bërë e padrejtë dhe ku ka ngecë, ndoshta në mungesë të fakteve janë marrë vendime jo të duhura domethënë faktet janë ato që e bëjnë një të vërtetë, të saktë dhe çfarë ishte dashtë të merret, domethënë ne nëse fillojmë të flasim ne kemi raste shumë të mëdha, unë veç po e përmendi një shembull në Pejë, një rast që ka ndodh para dy muajve apo tre nëse nuk gaboj kur një person është akuzuar nga fqinji i tij shqiptarë ka ardh disa herë dhe e ka vizituar pronën e tij edhe pse lëndën e ka pas në gjykatë, thjeshtë ai familjar ai është i zhgënjyer si gjykatë edhe ajo si gjykatë e Kosovës, kështu që domethënë të shohim nesër nëse na kemi përçarje këtu si iniciues të këtij komisioni, atëherë çfarë duhet të bëjmë ne si komision, t'i parandalojmë ata zëra që nëse na shkojmë me bisedu me ato familje dhe me mbledh fakte në momentin që kemi me u thënë që ju do të vini të dëshmoni në Serbi ose Kosovë ata menjëherë kanë me e ndërpre bashkëpunimin me neve, hajde do të gjejmë formë, të gjejmë mekanizma që të jem sa më afër tyre që të ju garantojmë që do të jetë një gjykim i saktë që të na japin fakte, dihet se nuk mund të akuzohet askush domethënë e pa dhe e pashë më e rëndësishme është domethënë që fotot flasin edhe fotot një gjykatës mund t'i hedh poshtë domethënë nëse je dëshmitar okular domethënë mos hezito mos ke frikë me e thonë, qoftë në Beograd qoftë në Kosovë qoftë kudo që të jesh mos me pas frikë domethënë ne duhet të gjejmë mekanizma që të jemi më afër atyre familjeve që i kanë humbur personat e tyre që mos t'i lejojmë që, ne kemi pasur rastin kur janë dënua disa persona për krime që i kanë bërë dhe del para një mediumi një analist dhe thjeshtë thotë që është bërë e padrejtë nuk është marrë vendikti i duhur, po hajt na thuaj zotëri fakte, unë si një qytetar kur ndi sado që besoj në gjykatë prapë mundem me dyshu që nuk është marrë vendimi i drejtë dhe nëse them unë që ky vendim nuk është marrë i drejtë duhet t'i ofroj fakte atij familjari ose atij personi

ose atij mediumi thjeshtë manipulohen edhe mediat nga personat, dihet që në qeveri gjithçka mundohet me politizim, ne si komision të mos politizohemi se nëse politizohemi atëherë s'kemi arrit asgjë hiq, faleminderit.

Vesna Tershelliq: Faleminderit shumë. Në vazhdim, Katarina Kruhonja.

Katarina Kruhonja: Katarina Kruhonja, unë jam nga Kroacia, Qendra për paqe, jo dhunë dhe të drejtat e njeriut nga Osijeku. Kur Natasha foli në fillim dhe tha se të gjithë ne, që jemi sot këtu, në njëfarë mënyre veç kemi hyrë thellë në këtë proces të përcaktimit të fakteve për krimet e kryera të luftës në territoret e ish- Jugosllavisë, kemi një lloj detyrimi para gjeneratave që po vijnë që t'iu japim faktet e vërtetuara. Pjesërisht mund të pajtohem me këtë, por në të vërtetë, po më duket se më e rëndësishme, e për të ardhmen edhe më e qëndrueshme do të ishte sikur të kishim arritur që të rinjve, e falë Zotit, këtu kemi shumë prej tyre, që në tërë këtë proces t'ua dorëzojmë këtë përvojë të bashkëpunimit të organizatave të viktimave, organizatave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, qytetarëve, respektivisht juridiksioneve, shteteve në rajon në përcaktimin e fakteve mbi krimet e kryera këtu. Kjo është një. E dyta, mendoj se me vet atë që ne kemi filluar të bëjmë punën që do të duhej ta bënin shtetet, dikush më shumë e dikush më pak, e kjo është diçka që tek...por unë këtë po e shoh si të përkohshme, si diçka që duhet bërë gjer atëherë kur shtetet të marrin përsipër ato që do të duhej ta bëjnë e assesi një Fond për të drejtën humanitare dhe Natasha, dhe i tërë ekipi i saj, apo ku ta di unë, një Qendër për hulumtim dhe dokumentim në Sarajevë e cila ka bërë një punë të madhe, regjistruar të gjithë të vrarët, prapëseprapë nuk mund ta marrë mbi vete barrën për të gjitha krimet, t'i përpunoj ato, dhe ajo iniciativë për të cilën po flasim ne, unë ashtu po e shoh, po i bën presion serioz në qeveritë në rajon, që të themelojnë komisionin, i cili do të kishte karakter rajonal, ku do të përcaktoheshin faktet mbi krimet e kryera dhe ku do të mund të shtojmë atë që ne e dimë. Ky është qëllimi ynë themelor. Qëllimi ynë themelor nuk është që të themi "Natasha, ti nuk e ke bërë këtë, e është dashur t'a bësh". Jo, ejani që ne t'a bëjmë këtë dhe ja, për këtë po flasim ne. Por, çfarë mund të bëjmë ne me qeveritë tona, nëse ju mendoni se ky mendim është i mirë, unë personalisht e përkrah këtë mendim, dhe kam shpresë në të, edhe pse po më duket shumë si utopike duke marrë parasysh se çfarë janë qeveritë tona. Por, nëse nuk provojmë, atëherë paraqitet pyetja se çfarë do të fitojmë. Nëse provojmë dhe nëse jemi me numër gjithnjë e më të madh së bashku, të themi" Ne e duam një komision të tillë, ne duam që ju të vërtetoni krimet në Kosovë dhe Bosnjë dhe Kroaci, " unë shpresoj se do t'a bëjmë së paku një hap në të gjithë procesin, i cili me decenie të tëra po zgjat, fatkeqësisht, viktimat nuk do të përjetojnë kënaqësinë e plotë, sigurisht shumica nga ata do të vdesin në ndërkohë por, me këtë komision mund t'a ndihmojmë atë proces. Faleminderit.

Vesna Tershelliq: Faleminderit Katarina. Urdhëroni.

Katarina Kruhonja: Unë dua të them se ai Komision, së paku unë ashtu e shoh, mund të plotësoj gjykimet. Disa shtigje, ja, t'iu jap shembull rastin e pallatit të Paulinit, krimin në Kroaci. Gjykata ka vërtetuar se, ku ta di unë, pesë kryerës krimesh me uniforma të ushtrisë kroate, kanë bërë masakër në 19 civilë serb. Njëri nga ata është dënuar, për të tjerët nuk kanë patur dëshmi. Por, bashkësia jonë e di për atë krim. Ky Komision mundet që viktimave t'iu jap një satisfakcion tjetër, të dihet në opinion për atë krim, se ka ndodhur, kush e ka kryer e kështu me radhë.

Vesna Tershelliq: Faleminderit Katarina. Shukrije Gashi.

Shukrije Gashi: Natasha ka bërë shumë edhe pse ka pasur vështirësi të shumta, çështjet, aktivitetet duhet t'i shohim në kuadër të kontekstit, të rrethanave dhe që nga viti 1990 e tutje këtë iniciativë duhet ta përsërisim si një qasje pozitive, unë gjithashtu nuk jam mendoj se edhe të gjitha këto mlllefet, paraqitet me mlllef nga ana e ish të burgosurve apo të atyre që kanë përjetuar

si diçka negative është vetëm një mënyrë e shprehjes së tyre, kurse mesazhet nuk i konsideroj që janë negative, përkundrazi aty ku ka kundërthënie ka edhe hapësirë për përmirësim, ka edhe hapësirë për të bërë përpjekje për të gjetur se cilat janë pikëtakimet se cilat janë interesat e përbashkëta, çka ne po duam me këtë iniciativë, ku po duam që të arrijmë, ne e dimë se me qenë organizata joqeveritare gjithmonë kemi me qenë në pozitën e atij që përpiket që të korrigjoj qeverinë, t'i fsheh, t'i mbulon ato zbrazësi ato hendeqe që ekzistojnë në qeveri, dihet cili është roli i OJQ-ve, prandaj kjo iniciativë mendoj se është e mirë, është një hap drejt një mundësie në të ardhmen që të bëhet verifikimi i rasteve, të vihet aq sa mund të vihet drejtësia në vend, ne e dimë që ky është proces dhe nuk është proces që zgjat një vit, dy vite, tre vite por do të merr kohë më shumë ne duhet të kemi durim më shumë ashtu qysh kemi pasur durim të kalojmë nëpër tërë këto vështirësi si luftën, ballafaqimet, krimet. Unë nuk jam në lëkurën e atyre që e kanë përjetuar dhe nuk pretendoj assesi që këtë unë ta ndjej njësoj, megjithatë duhet të kemi dhe të shprehim empati me palët e ndërsjella patjetër, ngase fundi i fundit të gjithë ata që kanë i kanë përjetuar krimet në lëkurën e tyre në çfarëdo lloj forme qoftë janë njerëz, qenie njerëzore, këto çështje dhe meqenëse jemi organizata joqeveritare duhet t'i shikojmë jashtë kontekstit politik, kur po them jashtë kontekstit politik nuk po mendoj assesi që ne ta përjashtojmë mundësinë që si organizata të bëjmë përpjekje maksimale që të ndikojmë në qeveritë tona të ndërsjella dhe them që ato të ulen dhe ta marrin seriozisht ta shtrojnë çështjen seriozisht, në këtë rast duhet theksuar gjithashtu se as qeveritë e Kosovës të pasluftës nuk kanë bërë kushedi se çfarë, që të ulemi dhe të bisedojmë, të hartojmë politika të qëlluara, të themelojmë trupa ose organe përgjegjëse, të cilat do të merren seriozisht me këtë çështje, prandaj edhe njëherë po e them për shkak të obligimit moral që e kemi duhet që të ulemi dhe ta marrim seriozisht këtë çështje nga rasti në rast dhe t'i shqyrtojmë dhe t'i japim mundësinë atyre që i kanë përjetuar krimet dhe luftën në lëkurën e tyre, që ata ta thonë fjalën e tyre duke qenë racional duke mos u lëshuar shumë në shpjegime me metafora për arsye se është vetëm humbje e kohës. Gjykatës i nevojiten faktet, numrat, ngjarjet, fajësia, emrat të gjitha këto, prandaj kjo iniciativë është e qëlluar, unë jam e mendimit që duhet të përkrahet, duhet të bëjmë çmos që t'i shfrytëzojmë përvojat fatkeqësisht të hidhura nga ish pjesët tjera të Jugosllavisë çfarë ato kanë bërë deri sot që drejtësia të vihet në vend dhe ne që t'i përfillim këto përvoja dhe të bëjmë diçka edhe në anën tonë dhe secilin rast ta marrim shumë seriozisht, në të kundërtën në qoftë se ne vazhdojmë me garime prej pikëpamjeve politike prej kornizave nacionale nuk do të arrijmë kurrë që të bëjmë diçka konkrete që të vazhdojmë me vite të tëra dhe të bëjmë një punë të kotë unë edhe njëherë po e them se në qoftë se mbetet vetëm tek qeveritë në Kosovë dhe në Beograd, rrethanat aktuale kur ato nuk janë stabilizuar dhe vendoset ashtu qysh duhet kjo iniciativë do të jetë shumë vështirë që ta merr kahjen e mbarë, edhe njëherë po them që kërkoj falje në qoftë se dikush do të preket këtu nga viktimat, pra shihet që unë nuk kam qenë në lëkurën e tyre por unë gjithmonë kam qenë në anën atyre të të cilëve iu janë shkelur të drejtat, pa marrë parasysh përkatësinë nacionale, racore, fetare e të tjera dhe do të jem gjithmonë, faleminderit!

Vesna Tershelliq: Faleminderit shumë. Eugen Jakovçiq.

Eugen Jakovçiq: Unë jam Eugen Jakovçiq nga Spliti dhe paraprakisht po ju kërkoj falje, nuk jam as viktimë, këtu jam si gazetar dhe profesionist po ju kërkoj falje të gjithë juve që jeni viktimat dhe të cilëve po u marrë kohën e çmuar, respektivisht kohën për të dëgjuar përvojat e juaja, sepse të gjithë jemi këtu për ju. Mirëpo më duhet të them se i tërë ky frustrim që vie në të vërtetë është i vlefshëm si ari, dhe mendoj se në njëfarë mënyre, po e vërteton, frustrimi juaj po e vërteton domosdoshmërinë e një komisioni të tillë, se në të vërtetë i gjithë ky proces ka dalur nga një frustrim kolektiv, të cilin të gjithë ne e kemi diku, si një përgjigje individëve në shoqëritë

tona. Se, sikur të gjitha gjykatat tona të funksiononin ashtu siç duhet, sikur elitat tona politike të funksiononin ashtu siç duhet, faktikisht as nuk do të kishim nevojë për një proces të tillë. Prandaj, të gjithë ne jemi të frustruar diku, por mendoj se është shumë e rëndësishme, dhe mendoj se kisha dashur të më kuptoni për qëllim të mirë, nuk kam përvojat e juaja dhe nuk dua që juve t'iu duket se diçka po ju imponoj, por mendoj se në këtë moment kam mirëkuptim të plotë për vuajtjet, edhe të tuajat personale edhe të popullit shqiptarë, në të vërtetë me decenie të tëra po e përcjellë të gjithë atë që po ndodh në këto territore, vërtet ju kuptoj plotësisht, por mendoj se në këtë moment, është shumë me rëndësi që këto frustrimet tuaja, e këtë po e them edhe në bazë të përvojave nëpër të cilat kemi kaluar ne në Kroaci, në të vërtetë duhet të drejtohen kah elitat tuaja politike, që pikërisht pavarësia juaj është pikërisht kjo, që institucionet tuaja të funksionojnë, që gjykatat tuaja të funksionojnë, dhe atyre në të vërtetë t'ua parashtroji pyetjet. Se ne gjithashtu kemi qenë të ngazëlluar për pavarësinë tuaj e të tjera, jemi të dehur por e kemi parë se kjo nuk po shkon atje ku kemi dashur, se nuk po i marrim përgjigjet, se jemi shumë të manipuluar dhe se i tërë ky frustrim i fuqishëm, të cilën plotësisht e kuptoj dhe e cila është absolutisht me vend, në të vërtetë duhet të drejtohet drejt institucioneve tuaja. E nga ana tjetër qëllimi, gjithashtu, edhe respektivisht rëndësia e këtij komisioni, aq sa e kam kuptuar unë, nuk është që ne të delegojmë dikë apo që ne të kërkojmë nga Natasha Kandiçi, Vesna Tershelliçi apo dikush i treti, i katërti, i pesti, a ku ta di unë, përgjigjet në disa pyetje. Absolutisht mendoj se të gjithë duhet të jemi pjesë e këtij procesi dhe sado demagoge të tingëllojë, po unë ashtu e kam kuptuar, se çdokush në mikroplanin e vet mund të jep kontributin e vet. Ju kërkoj falje por unë jam vërtetë i emocionuar, se këtë punë që e bëj edhe profesionalisht edhe në Kroaci, dhe në të vërtetë këtë e bëj prej një aspekti njerëzor. Dhe në fund, të ju ndihmoj në frustrimet tuaja, të cilat me të vërtetë i kuptoj, e që ka të bëjë me vendet e gjykimet. Është paradoksale të kërkonim që shoqëria serbe të ballafaqohet me krimet që janë kryer në emër të tyre, e të kërkonim që gjykimet të mbahen në Prishtinë dhe në Kosovë. Do t'ua jap një shembull për gjykimin e Lorës në Split. Ka patur diskutime mbi atë se çfarë situatë mbretëronte në Split dhe Dalmaci, gjykimet nuk do të mund të mbahen në Split por se duhet të mbahen në Zagreb. Ne, me të vërtetë shumë jemi munduar që gjykimi për burgun e Lorës të mbahet në Split e jo në Zagreb, respektivisht që Spliti dhe ai mjedis të ballafaqohet me atë proces dhe ato krime. Ju falënderohem, dhe kërkoj falje nëse e kam zgjatur shumë.

Vesna Tershelliçi: Të faleminderit Eugen. Amir Kullaglliçi.

Amir Kullaglliçi: Kemi përjetuar gjërat e njëjta edhe pse gjeografikisht kemi qenë të ndarë në anë të ndryshme të ish shtetit (Jugosllavisë). Unë jam Amir Kullaglliçi nga Srebrenica, jam lindur dhe kam jetuar në Srebrenicë dhe kam përjetuar, ashtu si shumica nga ju, gjëra të tmerrshme. Kam humbur dhjetë anëtarët më të afërt të familjes, kam humbur shumë miq, kam humbur shtëpinë dhe të gjitha ato që unë dhe gjenerata ime, ashtu si edhe familja ime, kemi fituar me vite. E pse? Sepse njerëzit e këqij i kanë dhënë vetes të drejtën që të më dënojnë se quhem Amir Kullaglliçi, dhe se në momentin e caktuar kam jetuar në vendin e caktuar. Përse jam unë viktimë apo pse ju ndiheni viktimë? Epo, sepse disa njerëz të këqij, juve dhe familjeve tuaja i kanë bërë shumë të këqija por ajo që ata na kanë bërë neve quhet krim, e ai njeriu që i ka bërë ato quhet kriminel. Asnjë kriminel nuk ka të drejtë në mëshirën tonë, nuk ka të drejtë për keqardhjen tonë prej një arsyeje të thjeshtë, se i ka dhënë të drejtë vetes që t'i bëjë shumë gjëra të këqija më të dashurve tanë. Apo neve personalisht. Po ju lutem, krimi nuk guxon që të mbetet i pagjykuar, në mënyrë që ai krim të mos përsëritet. Nëse nuk i dënojmë të gjithë kriminelët dhe nëse atë që ata e kanë bërë nuk e emërtojmë krim, atëherë do tu japim mundësi disa njerëzve të rinj të këqijtë bëjnë krime të reja përsëri ndoshta disa njerëzve tanë të dashur. Po ju lutem, për

çka ne si viktimë po luftojmë në të vërtetë? Po luftojmë për njëfarë të vërtetë. Por e vërteta, ato janë njëloj faktesh, disa informata, të cilat edhe neve do të na i zvogëlojnë shkallët e dhembjes sonë, të themi vuajtjes dhe frustrimit. Për dikë, kjo do të jetë informata se ku gjenden mbetjet mortore të të afërmit të tij, për dike do të jetë satisfakcion në kuptimin se e ka parë njeriun i cili i ka vrarë më të afërmit e tij dhe e ka përjetuar atë moment kur gjykata, si meritore e vetme, 'thotë atij në fytyrë 'Njeri ju keni bërë gjëra të këqija dhe për këtë do të ju izolojmë nga kjo bashkësi'', dhe me vetë këtë t'ia përcjellim porosinë disa njerëzve të rinj se nuk mund t'i bëjnë këto gjëra dhe të mbeten pa dënuar. Po ju lutem, kush është miku më i madh i të së vërtetës? Miku më i madh i të së vërtetës është koha. Nuk kemi mundur, unë në Srebrenicë apo pas Srebrenicës, në vitet 1996, 1997 që për këtë të bisedojmë në mënyrë adekuate. Unë ende isha përplot dhembje, pikëllim, hidhërim dhe gjithçka tjetër, por kanë kaluar 13 vite dhe unë në të gjithë atë, tani shikoj në një mënyrë tjetër, me qasje më racionale. Dhe të gjithë këta që janë këtu, nëse duan të përjetojnë ngushëllim nga ana ime, nuk guxojnë të miratojnë ato gjërat e këqija që dikush ia bën tjetërkujt dhe nuk guxojnë të arsyetojnë atë se dikush paska përjetuar disa gjëra të këqija, të arsyetohen se në emër të tyre kanë bërë gjëra të këqija apo të kryejnë krime. Ne duhet të ngrisin zërin tonë kundër kësaj. Por ju lutem, cili është armiku më i madh i të së vërtetës? Është paragjykimi zotërinj. Paragjykimi, e secili nga ne mund ta ketë definicionin e vet për paragjykim. Por ju lutem, paragjykim është nëse kërkojmë që gjithkush tjetër të bëj diçka për zbulimin e së vërtetës sonë. E ne vetëm rijsim ulur anash si në pusi edhe bile i sulmojmë ata që kanë bërë gjithë çka është e mundur, e që ne nuk kemi bërë asgjë në ndërkohë. Zotërinj më duket se kjo nuk është fer. Ja, kjo është më e buta që mund ta them, kjo nuk është fer. Dhe për këtë miq të dashur, do ti bie shkurt. Kjo iniciativë më nuk mund të jetë iniciativë, kjo veç është bërë pjesë e shumicës nga ne, ne jetojmë me këtë iniciativë, ne po e japim një pjesë tonën për këtë iniciativë, dhe për këtë po ju thërras edhe ju, si miq, të cilët keni përjetuar gjëra të ngjashme, bëhuni pjesë e kësaj storjeje, bëhuni pjesë e këtij procesi me atë që do të jepni kontributin tuaj konkret, me atë që do të mblidhni të dhëna, informata, të përkrahni iniciativën. Kështu edhe nëse shkoni diku në ndonjë mjedis, dhe dikush dikujt fillon ti shpërndajë thashetheme apo gënjeshtër mbi këtë iniciativë, për atë sepse nuk është i informuar sa duhet, ju ndërpriteni, sepse keni të drejtë të plotë, sepse keni qenë pjesë e kësaj storjeje. E dyta, bashkohuni me koalicionin e ardhshëm të joqeveritarëve, qeveritarëve apo ku ta di se kujt, më falni, domethënë bëhuni pjesë e koalicionit të organizatave joqeveritare, organizatave të shoqërisë civile e ashtu me radhë, me atë që do ti bëni të gjitha që në mjedisin tuaj ta afroni këtë iniciativë, të përfshiheni në të gjitha aktivitetet që do ti keni, ti përkrahni të gjitha ato dhe në fund, që rezultat i punës sonë të mundimshme të jetë Komisioni Rajonal për përcaktimin e fakteve mbi krimet e luftës në territorin e ish Jugosllavisë. Kjo do të jetë fitore e viktimave ndaj kriminelëve, por me këtë edhe e largojmë mundësinë që fëmijët tanë apo nipërit tanë të përjetojnë atë çka kemi përjetuar ne. Këta miq, të cilët tani ndoshta për herë të parë kanë pasur rastin të flasin për dhembjen e tyre, ashtu si edhe unë, ashtu si edhe shumë të tjerë, kemi dëshirë të flakët të flasim për vuajtjet tona dhe ti ndajmë ,e ju, por ju lutem, për këtë edhe Forumi të cilin do ta mbajmë në Prishtinë është metodë e mirë, ku do të kemi si aktivitet të veçantë, le të themi, të viktimave dhe për këtë propozoj, përgatituni për atë moment kur do të keni rast të shprehi dhembjen tuaj. Përgatiteni në mënyrë të thukët, koncize dhe flisni në vetën e parë njëjës, domethënë flisni për atë që ju vërtetë e keni përjetuar dhe që ju e keni parë. Me këtë do ta lehtësoni dhembjen tuaj, por edhe do të na ndihmoni që t'ju kuptojmë më lehtë, dhe së bashku të arrijmë gjer tek qëllimi i fundit, e ky është fitorja e së vërtetës dhe drejtësisë ndaj padrejtësisë dhe gënjeshtërës. Më falni nëse kam folur më gjerësisht dhe faleminderit për vëmendjen.

Vesna Tershelliq: Më nuk kemi askënd këtu në listë, po ja dora.

Milot Berisha: prapë kërkoj falje, veç desha me shtu edhe një send se diçka nuk e kam të kuart këtu, po mendoj në atë aspektin që gjykata e Hagës për shembull ka marrë disa vendime për disa njerëz që nuk të fajshëm apo diçka e tillë, çka ndodh tash në qoftë se komisioni vjen deri te të dhënat që ata kanë të involvuar në krime apo diçka ngjashëm, për shembull në Kosovë kena x raste, në serbi ka raste, ka raste në Kroaci, ka raste në Bosnje, a ka mandat komisioni, a do të ketë mandat komisioni mbi atë send përkundër vendimit të gjykatës së Hagës?

Vesna Tershelliq: Kjo varet prej asaj se çfarë do ti propozojmë qeverive por kur njëherë në të ardhmen qeveritë e themelojnë komisionin, ata atëherë ndoshta do të parashohin disa masa, e ndoshta jo. Por ajo që do të thuhet para komisionit, atë që do ta thënë viktimat, do ta dëgjojnë njerëzit dhe kjo do të shndërrohet në fakte të vërtetuara. Vetëm se, ja vetëm po lutem që kur flasim për komisionin, ajo do të jetë një trup zyrtar dhe nga momenti kur e themelojnë qeveritë nuk do të mundemi të ndikojmë drejtpërdrejtë në të, që do të thotë, do të vendoset në mandat të komisionit. Ne do të formulojmë së bashku një lloj propozimi, dhe kur njëherë të bëhet zyrtare, atëherë ajo do të përjetësohet.

Natasha Kandiç: Ju lutem, vetëm edhe t'a qartësojmë. Shikoni, edhe në rastet e gjykimeve sikur që janë *Treshja e Vukovarit*, *Limaj* apo *Haradinaj*, gjykata nuk ka vërtetuar se këto krime nuk kanë ndodhur. Absolutisht, aty është dëshmuar se, ku ta di unë, krimet e asaj akuze kanë ndodhur. Në rastet Limaj, Haradinaj apo Treshes së Vukovarit, Këshilli hetues i Gjykatës së Hagës nuk ka vërtetuar se këta të akuzuar janë përgjegjës për atë që ka ndodhur. Gjithkund është dhënë shpjegimi: ” *Për mungesë të dëshmive*”. Për ndryshe, sipas rregullës, komisionet për përcaktimin e fakteve, komisionet për të vërtetën, pas mbledhjes të të dhënave të arritura, mbledhjes së dëshmive, pas organizimit të dëgjimeve publike të viktimave, ata, të gjitha ato të dhënat gjyqësore, të mbledhura shtesë i analizojnë dhe e lëshojnë raportin. Komisionet nuk kanë mandat për të thënë ”Ai është fajtor, ai ka bërë atë”. Shikoni, fajin individual e vërtetojnë vetëm gjykatat. Komisionet kanë për detyrë të tregojnë se çfarë ka ndodhur, se çfarë thonë viktimat dhe të tregojnë kryerësit. E përgjegjësinë individuale e vërtetojnë ekskluzivisht gjykatat. Në atë kuptim komisionet do të ndihmojnë shumë punën e prokurorive me fakte, të të dhëna dhe dëshmi. Për ndryshe, vërtetë ta sqarojmë këtë njëherë, komisionet nuk do të thonë për shembull ” Ky dhe ky është fajtor, këtë duhet burgosur ”. Këtë nuk guxon ta bëjë asnjë komision ajo duhet, për shembull, të shpjegojë se çfarë ka ndodhur gjatë kohës së bombardimit të NATO-s. Të dhënat dhe faktet do të tregojnë se çfarë ka ndodhur. Faktet do të tregojnë se ku kanë ndodhur gjenocidet, faktet do të tregojnë se ku ka patur krim kundër njerëzimit, ku ka patur deportim, ku ka pasur përndjekje në bazën etnike e racore, faktet do të tregojnë se ku ka pasur vetëm tortura si krim lufte, ku është kryer krim i luftës në formë të plaçkitjes së pasurisë. Këtu do të tregojnë faktet dhe dëshmitë e mbledhura por në raportin e vet, komisioni nuk do të thotë ” Këta dhe këta njerëz duhet të burgosen”, këtë nuk guxon asnjë komision, nuk mundet, as nuk do të ishte mirë ta thoshte sepse atëherë kjo do të ishte vendosja e drejtësisë, ligjit në duart e atyre të cilët, sipas ligjit, nuk janë kompetent për përcaktimin e përgjegjësisë penale. Ne, me këtë raport, do të fitojmë shumë të dhëna mbi përgjegjësinë politike e institucionale, atë që vetëm Gjykata Ndërkombëtare e drejtësisë mund ta vërtetojë. Do të fitojmë të dhëna mbi atë se cilat institucione kanë bërë, e çka kanë lënë pa bërë dhe, kjo është ajo që do të jetë shumë e vlefshme më vonë për diskutim në shoqëri një herë kur të përcaktohet.

Vesna Tershelliq: Edin Ramulliq.

Edin Ramulliq: Unë jam Edin Ramulliq nga Prijedori, qytet, i cili fatkeqësisht, është njëri nga rajonet më të goditura nga krimet e luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë. Ne kemi evidentuar diku rreth 3200 viktima boshnjake, kroate dhe të tjerë. Këtu pranë meje është Zdravka Karlica, burri i së cilës është vrarë në një aksion të vetëm ushtarak, të cilin e kanë bërë boshnjakët në Prijedor. Unë kam humbur shtatë anëtarë të familjes sime, duke përfshirë babanë dhe vëllain, në llogoret e Prijedorit, Keraterm dhe Omarska, dhe vetë kam kaluar një kohë në llogor. Kur më kanë ftuar, kur më kanë kyçur në këtë forum, unë i kam lutur ata që më kanë ftuar mua, të kyçin edhe Zdravka Karlicën nga Prijedori, dhe ja, ajo tani po vie së bashku me mua, dhe është e kyçur në këto grupet e punës. Do të thotë, hapi i parë kah sektori joqeveritarë në organizatat e Prijedorit, ku e kemi bërë hapin e bashkëpunimit në Prijedor, ka qenë mu me organizatën të cilën e kryeson zonja Karlica. Kam patur disa herë rastin që edhe në Sarajevë edhe në Beograd t'i them se po turpërohem për shkak të llogorit Çelebiç, ky është llogor i vendosur nga ana e boshnjakëve, ku janë mbajtur serbët, në komunën Konjiç në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe askujt, absolutisht as një boshnjaku nuk i lejoj që në praninë time të zvogëlojë, apo që në çfarëdo mënyre të thotë se llogori Çelebiç është më pak i tmerrshëm se llogoret e Prijedorit: Keraterm, Omarska, Tërpolje e të tjera. Çka po dua të ju them? Atë që po e pres nga ju këtu, e para së gjithash prej nikoqirëve shqiptarë kosovarë në këtë qytet, po pres atë, që këtu e kemi dëgjuar nga Llazari dhe shoku i tij. Ata domethënë kanë pranuar ekzistimin e krimeve ndaj shqiptarëve kosovarë. Ajo që dua, edhe pse ka pasur indikacione, që për këtë të gjykohej qartë dhe haptas gjithashtu edhe për krimet ndaj serbëve kosovarë këtu. Para së gjithash kjo është detyrë e juaja si nikoqirë, dhe kjo është një nga para kushtet e vogla, që ne të gjithë së bashku të jemi edhe në këtë forum Rajonal, që të gjithë së bashku të punojmë në themelimin e Komisionit Rajonal e cila në fund do të rezultojë ashtu që të gjithë të jemi të kënaqur me faktet e përcaktuara, si produkt final të kësaj pune sonë. Ja, unë deshta vetëm përmes rastit të Prijedorit ku vërtetë kemi patur krime të tmerrshme dhe ku vërtetë është dashur të kalojë një kohë e caktuar. Ne nuk kemi komunikuar para dhjetë vitesh e tash e kemi bashkëpunimin më të mirë. Asnjë organizatë tjetër joqeveritare nuk ka bashkëpunim aq të mirë me ne, e supozoj se përvojë të njëjtë ka edhe zonja Karlica. Ja faleminderit, nuk dua t'ju marr kohën më tepër.

Vesna Tershelliq: Hysni Berisha.

Hysni Berisha Sa ma shkurtë dhe më konkret, jam Hysni Berisha vij nga Suhareka. Sigurisht keni dëgju për rastin e familjes Berisha, sigurisht që shumica prej juve nuk keni në Suharekë, por i keni marrë informacionet prej dikujt, prej dikahit qoftë prej mjeteve të informimit, qoftë prej filmave dokumentarë, qoftë prej përfaqësimit në dëshmitë në Tribunalin e Hagës, në Gjykatën e Beogradit edhe në format tjera. Unë të them të drejtën që nga 13 qershori 1999 vetes dhe me disa familjar që kemi mbet pak ia kemi parashtruar vetes detyrë që ta nxjerrim të vërtetën për të gjitha këto krime që kanë ndodh aty dhe aktivitetet tona i kemi shtri në dy kahje, në dy drejtime, një ka qenë që t'i zbulojmë eshtrat e më të dashurve tanë edhe pas 9 viteve nuk kemi arrit që së paku të dimë ku i kanë varrezat dhe e dyta ka qenë që të prezantojmë faktet, dëshmitë dhe t'i nxjerrim kryesit e krimeve para drejtësisë. Unë dhe me disa familjar kam qenë në Tribunal të Hagës dy here, kam dëshmuar në procesin e Slobodan Millosheviqit, për fat të keq që për mua ka mbet një çështje e hapur, sepse Zoti dashti atij ia mori jetën pa e marrë aktgjykimin e merituar, kjo është për ne ndoshta që ne e ndijmë një barrë shumë të rëndë sepse nuk arritëm që për të gjitha ato krime që i ka bërë, të paktën të merr dënimin e merituar. E dyta kam qenë në dëshminë në procesin e Millutinoviqit dhe të tjerët gjithashtu edhe aty i kemi përcjellë faktet dhe dëshmitë tona, është ajo ndoshta e keni përcjellë përmes mjeteve, transmetimi që është bërë gjatë prezantimit të dëshmimeve për të vetmin rast që në mënyrë publike Millosheviqi e ka pranuar krimin për rastin e

Suharekës të familjes Berisha. Në rastin e Millosheviqit gjithashtu e keni Millutinoviqit gjithashtu i kemi prezantu provat dhe dëshmitë tona, duke u nisur nga fakti që e drejta nuk ndalet me e kërku vetëm në dy ose në pesë persona ngase nuk janë vetëm ata që e kanë shkaktuar gjithë këtë katrahurë mbi ne. Ne kemi kërkuar edhe më tutje duke u nisur nga ajo që mandati i Tribunalit të Hagës është në përfundim e sipër, të vërtetën nuk mundemi ne ta mbyllim por kemi kërkuar edhe përmes formave të tjera, kemi bashkëpunu duke iu falënderuar Natasha Kandiqit, kemi bashkëpunua dhe është ngritë aktakuza për rastin Berisha për tetë serbë, 7 lokal dhe një komandant nga Nishi, gjykimi i të tjerëve vazhdon edhe sot qe dy vite, në dhjetor më tre dhjetor të vitit të kaluar unë vetë kam qenë në dëshmi në Beograd, duhet të ju them një gjë e di që kanë shumë nervoz të akuzuarit sepse ata s'e kanë ditë që unë do të shkoj me dëshmu, e di që kanë qenë shumë nervoz avokatët e tyre sepse nuk kanë besu që unë do të shkoj me dëshmu atje, kanë ardh në përfundim që ata nuk kanë qenë të kënaqur me dëshmitë që ne i kemi ofru, të gjitha dëshmitë i kemi prezentu me fakte, me argumente, bile bile tuj qenë ata nervoz, në një rast avokatët më kanë akuzu si dëshmitar profesional dhe s'kemi na me këtë, mundemi me thënë që është i përgatitun dhe s'e dimë për cilat agjenci ka punu, kjo është ajo çka dua të ju them duhet që të gjithë ne që jemi viktimë e që kemi dëshmi ju lutem që t'i grumbulloni dëshmitë dhe t'i prezantojmë te institucionet ku është e domosdoshme sepse vetëm aty mundet me u nxjerrë e vërteta, dua të ju them edhe për një gjë që më ka dhënë edhe më tepër forcë, që më ka shtu edhe forcë më tepër ka qenë takimi me ambasadorin në Beograd pas dëshmisë, ku mu ka drejtu me këto fjalë zoti Berisha të falënderoj që ke ardhë me dëshmu në Beograd, unë e kam ndi veten në një formë tash çka po kërkon falje ky tash një falënderim prej meje edhe iu kam drejtu me këto fjalë zoti ambasador ju nuk keni nevojë me më kërkua falje po unë ju kërkoj juve sepse ju ma keni mundësua që unë me qenë sot në Beograd edhe me u ballafaqua me kryesit e krimit dhe me ia thënë ato që ju e keni krye krimin e sa i përket gjithë asaj se e vërteta është e hidhur është e vështirë me ardh deri te e vërteta, ndoshta që unë jam i moshuar, ndoshta që edhe të tjerët pas meje kanë punë të merren me të vërtetën, një gjë mund ta di që nëse e vërteta nuk nxirret në shesh kam frikën se historia ka me u përsërit, ne kemi edhe përvoja të hidhura nga lufta e dytë botërore edhe nga lufta e parë botërore, e kemi rastin e Tivarit, edhe sot e kësaj dite nuk dihet për atë masakër se çka ka ndodh e si ka ndodh, nëse sot ne e kemi atë liri që me i grumbullua dhe me i hulumtua faktet për hir të gjeneratave që do të vijnë pas neve prandaj këtu është poenta jonë dhe këtu janë qëllimet tona dhe prandaj pa e nxjerrë të vërtetën unë nuk shoh shpresë, ju faleminderit.

Vesna Tershelliq: Shumë faleminderit. A kemi edhe ndokënd? Ja edhe një dorë, urdhëroni.

Ramadan Asllani: Shoqata 'Rrezja e shpresës' Ferizaj. Përshëndetje për pjesëmarrësit e ish Republikave të ish Jugosllavisë, përshëndetje për organizatorët që kanë marrë mundimin dhe kanë ardh këtu, mirë se kanë ardhur, duke shpresuar që kanë gjetur edhe një siguri ashtu siç e kanë gjetur ashtu edhe do të kthehen se Kosova është një vend që jo vetëm ata që kanë qenë por edhe ata që do të vijnë janë të mirëseardhur dhe mund të rrinë. Unë gjatë këtij takimi dhe gjatë të tjerave që kam dëgjuar do të doja të shkoqis disa çështje, çështja për të cilën do të diskutojmë këtu edhe pse është e thirrur nën organizimin e Fondit Humanitar nuk do të doja ta trajtoja si çështje humanitare për shkak se çështja humanitare është çështje e vullnetit, çështje e dëshirës, çështje e qefit, po çka do të doja të trajtohen këto, këto do të doja të trajtohen si çështje e të drejtës së të drejtës së familjarit për kërkimin e familjarit të tij që është e garantuar me konventën ndërkombëtare, nëse këto dy çështje e dallojnë çështjen e vullnetit nga çështja e të drejtës besoj se kjo e dyta do të jetë më prioritare dhe do t'i përshpejtoj proceset ngase i garanton një të drejtë

të çdo qytetari, çdo familjari për kërkimin e familjarit të tij të pagjetur ose si dëshmitarë i një ngjarje, të ofrimit të fakteve e të tjera, ju përshëndes, ju faleminderit!

Vesna Tershelliq: Pikërisht në kohë të paraparë po shkojmë te përfundimet. Kjo ka qenë një përgatitje e shkëlqyeshme për Forum. Tani shkurtimisht do të përmbledhim atë çka kemi dëgjuar. Do të filloja nga fjala e Lush Krasniqit se nuk ka rëndësi se cila gjykatë gjykon, kryesore është që të gjykohet dhe se është e rëndësishme të përcaktojmë faktet mbi krimet, dhe kurdo që të jetë e mundur të hulumtohen ngjarjet, të ngritën akuzat dhe të shkohet në proceset gjyqësore. Për ato raste dhe hulumtime të cilat nuk do të shkohet gjer në fund, ato të paraqiten para një trupi rajonal zyrtar, para komisionit rajonal.

Natasha Kandiç: Ajo që është e rëndësishme për konsultimet e sotme është se kemi arritur sukses që t'i afrohem kësaj iniciative për themelimin e komisionit rajonal për përcaktimin e fakteve mbi krimet e luftës. Rrjedha e diskutimeve të sotme tregon se kemi mjaft paragjykime me të cilat nisemi dhe vijmë të marrim pjesë në ndonjë diskutim, por me kohë, nën presionin e fakteve dhe argumenteve, e ndërrojmë rrjedhën e diskutimit. I falënderohem të gjithë pjesëmarrësve nga Kosova sot, të cilët kanë insistuar në fakte. Nuk është lehtë të arrihet gjer te ky kuptim, se faktet janë më të rëndësishmet në këtë proces të ballafaqimit me të kaluarën. Pa fakte, ashtu siç shumica ka përsëritur, na kërcënohet rreziku që të mos ia arrijmë të themelojmë dhe ndërtojmë kujtesën shoqërore, dhe garancionin se krimi nuk do të përsëritet. Më duhet të them se asnjë herë nuk ka ndodhur, në asnjë tubim gjer më tani, që të ketë mvëshje, akuza se nuk është bërë kjo, se nuk është bërë ajo. Mua personalisht më ka tronditur që kjo po vjen nga Gjakova. Keni bërë diçka me të cilën keni treguar qëndrimin tuaj ndaj viktimave tjera. Ju keni folur për rastin e Dubravës, ku kanë qenë mëse 200 të burgosur, e mandej keni anashkaluar tërësisht faktin se ekzistojnë rastet, edhe shumë raste, të cilët janë më masiv nga natyra. Aty te Gjakova është Meja, aty ka qenë Korenica, aty është Qabrati, aty janë fshatrat e shumta. Po ju asnjë moment nuk jeni kthyer në to, as nuk jeni kthyer në ato çka ka ndodhur në Gjakovë, as nuk jeni kthyer në atë se çfarë do të kishte ndodhur në atë Gjakovë sikur unë të mos kisha hyrë në Gjakovë. Ju lutem, herëve tjera kur të merrni pjesë, në tetor në Forum, ju lutem mos e përsëritni gabimin, po keni kujdes edhe për viktimat tjera dhe për atë se çfarë është toni në ndonjë diskutim. Po, shumë më gëzon fakti që këtu disa herë është dëgjuar dhe që keni sqaruar në mënyrë fantastike se përse janë të rëndësishme dhe përse na duhen faktet. Sipas mendimit tim ky është rezultati më i madh i këtij konsultimi, që këtu në Kosovë u dëgjua sa janë të rëndësishme faktet. Falënderim të posaçëm i kam borxh Aleksandrit dhe Lllazarit që po marrin pjesë sot dhe që kanë thënë diçka që është e rëndësishme se askush nuk do të mohoj krimet që kanë ndodhur por që është e rëndësishme që të vërtetohen faktet mbi të gjitha viktimat dhe rrethanat në të cilat viktimat kanë pësuar ose janë zhdukur. Gjithashtu është e rëndësishme që ata të cilët me vite të tëra janë marrë me të drejtat njerëzore, e ka mjaft prej tyre këtu, para së gjithash Shukrije Gashi, të cilët kanë sensibilitet të posaçëm për atë se çka do të thotë në të vërtetë të luftosh për një ide e cila është më se e domosdoshme, e cila është nevojë e shoqërisë. Ajo është nevojë për të përcaktuar faktet mbi krimet e bëra, të jetë e prezantuar publikisht në formën faktike që do të pengojë çfarëdo manipulimi dhe çfarëdo keqpërdorimi, do të kisha thënë se ky është kontributi më i madh i konsultimeve të sotme, se ne i jemi afruar seriozisht kuptimit përse na nevojitet Komisioni Rajonal për përcaktimin e fakteve mbi krimet e luftës. Ajo që po më duket si konkludim i rëndësishëm, në bazë të asaj se çka është thënë sot, është që para Forumit në tetor ne duhet të mbajmë edhe një ose dy takime në Kosovë, dhe të zgjerojmë rrethin e pjesëmarrësve, sepse në mesin e pjesëmarrësve të sotëm ka shumë të tillë të cilët shumë mirë, qartë dhe në mënyrë precize, e kuptojnë se çka do të thotë qëndrimi faktik ndaj trashëgimit të krimeve të luftës. Në

këtë mënyrë, Kosovën po e afrojmë plotësisht afër shoqërive tjera, Bosnjës, Kroacisë dhe Serbisë. Falënderim të posaçëm për pjesëmarrësit nga Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina të cilët në një mënyrë shumë të mirë, të dokumentuar dhe me shembuj, kanë treguar se si arrihet gjer te momenti ku jemi tash, se me qëndrimin ndaj tjerëve më së tepërmi arrihet gjer te ajo, që të gjithë së bashku, në mënyrë të njëjtë t'a diskutojmë idenë mbi themelimin e Komisionit Rajonal. Mirko Kovaçiq, sot ka thënë diçka, që është shumë e rëndësishme dhe e mirë që të dëgjohet, dhe e falënderoj për këtë Edin Ramulliqi ka thënë diçka të rëndësishme dhe unë asaj do ia shtoja edhe këtë. Ai ka përmendur llogorin Çelebiç-i. Nuk do të besoni, kur ne në Beograd kemi organizuar takimin në të cilin është bërë fjalë për atë se çka ka ndodhur në llogorin Çelebiç-i ku kanë qenë të burgosur serbët, çfarë vendimi gjyqësor, atëherë ka ardhur Edin Ramulliq-i dhe shumë njerëz nga Prijedori, të cilët kanë ardhur të përkrahin ata ish-llogorashat, t'u japin përkrahje dhe të tregojnë bashkëndjenjen dhe solidaritetin për atë çka kanë mbijetuar. Ky është rast unik ,dhe ne shumë herë e kemi përmendur publikisht. Sa larg kemi shkuar ne, me vetë atë që ata njerëz e kanë ndërmarr atë hap. Apo sa kemi fituar ne sot me vet këtë që Lush Krasniqi ka folur kështu, që Shukrije Gashi ka folur kështu, që Ferdane Osmani ka folur kështu, dhe që shumë të tjerë sot kanë folur në mënyrën pozitive dhe konstruktive. Kjo është diçka që është më e vlefshme në këtë diskutimin e sotëm, sepse ne nuk kemi patur më parë kesi lloj tubimesh këtu. Për këtë arsye duhet të vazhdojmë, dhe unë ju lutem që të përkrahni këto dy takime përgatitëse, të cilat do t'i mbajmë me siguri në fillim të shtatorit. Në këtë do të punojnë Valdete Idrizi, Bekim Blakaj dhe Sarah Maliqi, e po ju lus që të gjithë të kyçeni në të, të provojmë që zëri nga Kosova të jetë në nivelin e fakteve, ashtu si së paku dhjetë vetë e kanë thënë sot. Nëse ndokush ka edhe diçka për të shtuar, urdhëroni.

Mbajtjen e konsultimeve Rajonale me viktimat, të rinjët, gazetarët dhe organizatat për të drejtat njerëzore në Komisionin Rajonal për përcaktimin e fakteve mbi krimet e luftës në ish-Jugosllavi i kanë përkrahur: BTD The Balkan Trust for Democracy, dhe NED National Endowment for Democracy.